# GAZETA SHQIPTARE

Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com

Viti XXVI - Nr. 7886 E shtunë 18 Maj 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)



PR PRESTIGE Resort





Opinioni i Ditës

Nga PANO HALLKO



## Shqipes i mungojnë dy flatra...

Për njëmbëdhjetë ditë rresht, në vendin tonë mbizotëroi klima e rëndë shpirtërore, te të gjithë shqiptarët. Brenda këtij harku kohor, dy ditë ishin ...

Vijon në faqet 20-21

Opinioni i Ditës

Nga FATOS ÇOÇOLI



## Në kërkim të dëshpëruar të emisarit perëndimor

Kryetari i opozitës kërkoi pardje ndihmën e ndërkombëtarëve për të zgjidhur krizën. Dy vjet më parë, në maj 2017, tuneli i krizës politike tek ne dukej më i shkurtër ...

Vijon në faqen 21

AGJENCIA E KADASTRES: FAMILJET QE FITOJNE TE DREJTEN MBI TRUALLIN E NDERTIMIT

# LEGALIZIMET, EMRAT E 500 PRONAREVE QË MARRIN TAPITË

Tokat e zëna nga ndërtimet pa leje, shpërndahen certifikatat e pronësisë. Përfituesit në Tiranë, Durrës, Elbasan, Fier, Shkodër e Vlorë



*(Në foto)* Ndërtime informale

Në faqet 10-12




Përplasja personale mes dy presidentëve

## Topi: Nishani servil, e mora nga pompist e futa në PD. Replika: Haje paçe pa paguar

Kujtimet e Bamir Topin ndezin sherrin: Mediokër. Përgjigjet Nishani: Qelepirxhi, nuk të donte njeri

VALENTINA MADANI

Ish-presidenti Bamir Topi përmes librit të tij "Nocturn" ka nxitur një përplasje të ashpër me pasar-dhësin e tij, Bujar Nishani, teksa tregonte si e kishte njohur në një pikë karburanti dhe më pas e kishte futur në PD. Por, për Bujar ...

Në faqen 4

KREU I OPOZITES

### Basha në parlamentin britanik: Vendi ndodhet në krizë të rrezikshme

Në faqen 2

OPERACIONI "ANTI-SKIFTER"

### Bastisi 25 banesa në Gjermani për 3 vjet, kapet dibrani i shpallur në kërkim europian

Në faqen 6

POLICIA DO TE REAGOJE

### Ministri Sandër Lleshaj: Kush saboton votimin, do të japë llogari para ligjit

Në faqen 7

"BLUETOOTH"

### Klea Hanson: Nuk mjafton paraqitja, por zgjuarsia dhe të ndihmosh njerëzit

Suplement

APELI I PRESIDENTIT



### Meta, thirrje politikës: Thirrini mendjes, merrni përgjegjësitë

Në faqen 3

Dr. Andrea Mogni flet për eksperiencën 25-vjeçare në Komisionin Europian

## Këshilltari i BE-së te "Luarasi": Integrimi do reforma

*Leksione të hapura me studentët, Ruka: Traditë në universitetin tonë*

NGA VOLTIZA DURO

Integrimi në familjen e madhe europiane vazhdon të mbetet një prej objektivave kryesore të Shqipërisë. Ndër kriteret që duhen përmbushur për t'u bërë pjesë e BE-së janë edhe reformat ekonomike. Ky ishte thelbi i leksionit të këshilltarit të lartë të BE-së, Andrea Mogni, para studentëve të "Luarasit". Ai është një nga këshilltarët në fushën e financave dhe ekonomisë dhe rikthehet për herë të dytë në Shqipëri, me synim avancimin e procesit ...



Në faqen 8

# SITUATA POLITIKE
## AKUZAT

Kreu i opozitës me konservatorët britanikë. Zgjedhje politike, PD me model perëndimor

# Basha në parlamentin britanik: Vendi ndodhet në krizë të rrezikshme

## "Të ndajmë krimin nga politika"

Valentina Madani

Kreu i opozitës, Lulzim Basha, zhvilloi një vizitë në Britaninë e Madhe nga ku konfirmoi angazhimin e PD-së për një zgjidhje politike të krizës, që do të garantojë zgjedhje të lira dhe të barabarta. Në selinë qendrore të Partisë Konservatore britanike në Londër, kryetari i PD, Lulzim Basha u prit nga kryetari i Partisë Konservatore britanike, z. Brandon Lewis. Kryetari Basha i shprehu kryetarit Lewis mirënjohjen për mbështetjen e jashtëzakonshme që Partia Konservatore po i jep Partisë Demokratike për komisionin e përzgjedhjes së kandidatëve sipas modelit britanik, në kuadër të modernizimit, hapjes së PD dhe fuqizimit të mëtejshëm të anëtarësisë në procesin e organizimit të primareve. "Basha i shprehu kryetarit Lewis vendosmërinë e tij për ta modernizuar Partinë Demokratike sipas modeleve më të mira perëndimore, ku përvoja britanike në këtë drejtim është nga më të vyerat. Përfshirja direkte e përzgjedhësit kryesor të konservatorëve britanik (Chief Assessor) në ngritjen e komisionit të përzgjedhjes së kandidatëve në parti ka një domethënie shumë të madhe për bashkëpunimin e mëtejshëm afatgjatë midis dy partive simotra. Në takim mori pjesë edhe kryetari i degës së PD-së në Britaninë e Madhe, z. Naim Hasani", thuhet në njoftimin e PD-së. Dy kryetarët biseduan më tej për bashkëpunimin e ngushtë dypalësh në shkëmbimin e ekspertëve me të mirë, në menaxhimin e fushatave elektorale si dhe në organizimin e brendshëm të partisë.

**ZGJEDHJET**

Gjatë vizitës së punës në Londër, Lulzim Basha dhe delegacioni që e shoqëron u takua nga kryetarin e Komisionit për Punët e Jashtme në Parlamentin britanik, Tom Tugendhat. Në takim u diskutua mbi gjendjen ku ndodhet vendi, krizën politike dhe situatën në tërësi në gadishullin e Ballkanit. Lideri i opozitës konfirmoi angazhimin e Partisë Demokratike dhe të së gjithë opozitës së bashkuar për një zgjidhje politike të krizës, që do të garantojë zgjedhje të lira: "Duke ndarë politikën nga krimi, duke i zgjidhur duart drejtësisë që të vërë para ligjit politikanët e përfshirë në shitblerje votash me krimin e organizuar si dhe afera të tmerrshme korruptive. Reformë e thellë politike për fuqizimin e rolit të qytetarit sipas praktikave më të mira të vendeve demokratike perëndimore është angazhimi ynë", - theksoi Basha. Kreu i opozitës theksoi rolin e rëndësishëm të Britanisë së Madhe, në bashkëpunim me partnerët e tjerë strategjikë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimin Europian, në mbrojtje të demokracisë dhe shtetit të së drejtës. Basha e falënderoi Tugenthat për qëndrimin që ka mbajtur Anglia në raport me çështjen e nxehtë të "ndryshimit të kufijve" mes Kosovës dhe Serbisë, e cila duket se u mbyll përfundimisht në Samitin e Berlinit disa ditë më parë. Sipas Bashës, ndarja dhe shkëmbimi i territoreve mes Kosovës dhe Serbisë do të ishte një precedent i rrezikshëm dhe që do vinte në pikëpyetje paqen dhe stabilitetin në rajon. Pjesë e bisedës ishte edhe bashkëpunimi mes Shqipërisë dhe Anglisë në fushat e interesit strategjik. Kreu I PD-së, gjatw vizitës në Londër u takua mbërmë edhe me komunitetin shqiptar që jeton në Britaninë e Madhe.



Kreu i opozitës, Lulzim Basha, dje në Britaninë e Madhe

### Basha: Në Akademinë e Shkencave po gatuhet "zgjedhja" e Gjinushit

Kreu i PD-së, Lulzim Basha, akuzoi dje kryeministrin Rama se po kap edhe Akademinë e Shkencave. Sipas tij, ashtu si "zgjedhjet" e tjera false, edhe në ASH po gatuhet "zgjedhja" e Gjinushit. Basha tha se Rama dhe banda në pushtet dhunon shkencën dhe artin njësoj si demokracinë, pronën, qytetarin, ekonominë, të drejtat politike, drejtësinë. "Ashtu si 'zgjedhjet' e tjera false, edhe në Akademinë e Shkencave po gatuhet 'zgjedhja' e Gjinushit. Rama dhe banda në pushtet dhunon shkencën dhe artin njësoj si demokracinë, pronën, qytetarin, ekonominë, të drejtat politike, drejtësinë. Asnjë hap pas!", shprehet z.Basha.

### BARDHI: SULMI NDAJ "BILD", PREJ GANGSTERËVE NË QEVERI

Sekretari i përgjithshëm i PD-së, Gazmend Bardhi, shprehet se kush sulmon gazetën "Bild" do të ketë fundin e gangsterëve me të cilët qeveris. Bardhi deklaron se kush ka zgjedhur të vjedhë e të blejë vota me krimin e organizuar, është i destinuar të ikë. "Kush sulmon gazetën 'Bild', që i zbulon telefonatën për vjedhjen e zgjedhjeve dhe fshihet prapa fustanit të Blerina Gjylametit do të ketë fatin e gangsterëve me të cilët qeveris! Kush ka zgjedhur të vjedhë e të blejë vota me krimin e organizuar, është i destinuar të ikë!", - theksoi z.Bardhi.

"Protesta e 25 majit do të gjunjëzojë kryehorrin Rama"

## Noka në Shkodër: Jemi edhe në fushatë, po ngremë shtabet elektorale

PD-ja po përgatit strukturat e saj në mbarë vendin për një pjesëmarrje sa më të madhe në protestën e 25 majit në Tiranë. I deleguari i PD-së në qarkun e Shkodrës, Flamur Noka, theksoi se kjo do jetë protesta më e madhe që do zhvillohet nga opozita. "Largimi i Ramës është emergjent, pasi Shqipëria po rrëshqet çdo ditë drejt diktaturës. Sot të gjithë jemi dëshmitarë të arrestimeve politike, ai po tenton të rikthejë diktaturën. Largimi i tij është emergjencë kombëtare. Ne jemi duke intensifikuar aksionin dhe duke u bërë gati për protestën më të madhe të historisë, atë të 25 majit, që do të gjunjëzoje kryehorrin dhe kryebanditin Edi Rama", deklaroi z.Noka. Sipas tij, Rama është rrëzuar nga qeveria de facto dhe se shumë shpejt do të vijë dita që ai do rrëzohet de juro. Noka u bëri thirrje gjithë shqiptarëve që më 25 maj të marshojnë drejt Tiranës për të rrëzuar qeverinë Rama. "25-sa është apel për çdo shqiptar, të shkojmë drejt Tiranës dhe t'i japim goditjen finale klikës së dhunës. Do të jetë protesta më e madhe dhe që do t'i japë një leksion qeverisë së krimit", u shpreh Noka. Ish-deputeti theksoi edhe njëherë që nuk do ketë zgjedhje më 30 qershor. "PD-ja është e vendosur që më 30 qershor me Edi Ramën kryeministër nuk ka zgjedhje. Jemi duke përshkallëzuar aksionin e saj. Në ditët në vijim do të njiheni edhe me detajet e tjera të këtij aksioni. E përsëris, nuk ka zgjedhje me Ramën në krye më 30 qershor. Zgjedhje do ketë sigurisht pas largimit të Edi Ramës. Ne do të jemi edhe në fushatë, edhe në protestë. Shtabet po i ngremë për protestat dhe fushatën që do të vijë", deklaroi z.Noka.





Protesta e fundit e opozitës



### SHBA, mesazh për amerikanët: Kujdes gjatë protestave të opozitës!

Ambasada e SHBA-ve në Tiranë dje bëri një tjetër njoftim për shtetasit e saj në Shqipëri që të shmangin lëvizjet në vendet ku pritet që të zhvillohen sërish protesta nga opozita joparlamentare dhe që e radhës pritet që të jetë në datë 25 maj. Ambasada u kërkon shtetasve të saj që të kenë kujdes, pasi në tubimet e fundit, 11 dhe 13 maj, protestuesit kanë përdorur pajisje shpërthyese, bomba molotov dhe mjete të tjera të dhunshme, ndërsa policia është përgjigjur me gaz lotsjellës dhe ujë për të shpërndarë turmën. "Shmangni grumbullimet e mëdha dhe vendet ku demonstratat janë të pashmangshme ose në vazhdimësi. Monitoroni mediat për përditësime dhe mos u ekspozoni", është njoftimi i ambasadës për shtetasit e saj. Ambasada e SHBA-ve ka dënuar dhunën në protestën e 13 majit nga opozita shqiptare.

REDAKSIA: **Redaktor i Suplementeve dhe Sociales:** Rezarta Delisula, **Redaktor i Rretheve:** Trëndafile VISHA, **Redaktor i Kulturës:** Fatmira Nikolli, ***Art Designer:*** Nevila SAMARXHI.
ADMINISTRATA: **Përgjegjëse e Financës:** Alma Smokthina 0682074397, **Shpërndarja:** Elvis Llaka Cel 0682074416, ***Marketingu*:** Cel:**0688087823-*email:marketing@gazetashqiptare.com*, ADRESA**: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotraktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 ***Marketingu*:** Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, **Internet**: www.balkanweb.com, **Email**: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, **SHTYPUR në "Klasik"Shpk**



### Kreu i shtetit: Vendi s'mund të shkojë në përplasje civile për interesa okulte

# Meta, thirrje politikës: Thirrini mendjes, merrni përgjegjësitë

## *Presidenti dhe Balla "bashkohen" për integrimin dhe LANÇ*

Valentina Madani

Presidenti Ilir Meta paralajmëroi dje se për interesa tërësisht egoiste dhe okulte, Shqipëria po shkon drejt konfrontimit, nëse përgjegjësit nuk i thërrasin mendjes. Në një situatë të tillë, Meta i bëri dje thirrje politikës të marrë përsipër përgjegjësitë, për të mos e thelluar krizën dhe për të shmangur çdo përplasje civile. Ndaj, në kushtet kur asnjë nga palët politike në vend nuk po bën hapa pas për të kaluar krizën, Meta apelon se ka ardhur koha që politikanët të marrin përgjegjësitë për të mos i çuar shqiptarët në përplasje me njëri-tjetrin. I pyetur nga mediat nëse rrezikohet përsëritja e vitit '97, ai tha se vendi s'ka pse përjeton të tilla ngjarje për interesa egoiste dhe okulte të politikanëve. "Pas 22 vitesh, që kur Shqipëria u nda në vitin 1997, që ishte një vit mjaft fatkeq, të gjithë t'i thërrasin mendjes dhe të marrin përgjegjësitë e tyre, sepse për interesa tërësisht egoiste dhe okulte, Shqipëria nuk ka pse të shkojë në konfrontim dhe as shqiptarët me njëri-tjetrin. Ata kanë vendosur të bashkëjetojnë në mënyrë demokratike dhe janë ndarë me sistemet përjashtuese që në vitin 1990", u shpreh z.Meta. Kryeministri Rama deklaroi në fundjave së presidenti nuk është kontaktuar asnjëherë në cilësinë e një negociatori për një tryezë dialogu mes krerët e opozitës. I pyetur për këtë deklaratë, Meta deklaroi se zgjidhjen palët e kanë vetë në dorë dhe u kujton pasojat që i presin nëse 30 qershori kthehet në një ditë konfrontimesh mes mbështetësve të tyre. "Askush nuk mund t'i transferojë përgjegjësitë te të tjerët, aq më tepër te Presidenti i Republikës. Ata e dinë vetë shumë mirë se çfarë duhet të bëjnë dhe duhet të jenë të ndërgjegjshme për pasojat që do të kenë në rast se do ta çojnë vendin drejt konfrontimit", deklaroi kreu i shtetit. Në një komunikim me gazetarët, Meta u kujtoi drejtuesve të klasës politike në vend se situata aktuale ndikon edhe në sektorin e turizmit. "Këto interesa nuk i kanë ata, të cilët mezi po presin turizmin dhe shtimin e rezervimeve dhe jo anulimin e rezervimeve", theksoi kreu i shtetit. Pak ditë më parë presidenti tha se ka pasur takime që nuk janë bërë publike, me në fokus nxitjen e dialogut për të dalë nga kriza politike, në të cilën ndodhet vendi prej disa muajsh. Ekzaktësisht dy vjet nga marrëveshja mes tyre, Rama dhe Basha duken ende shumë larg një akordi të ri. Kryeministri ka deklaruar se është gati të dialogojë me Lulzim Bashën, por pa kushte, ndërsa kreu i demokratëve thotë se do të pranonte një tryezë të ndërmjetësuar nga ndërkombëtarët me kushtin e panegocueshëm të largimin të Ramës nga drejtimi i qeverisë. Mbrojtja dhe vlerësimi i Luftës Nacional Çlirimtare ishte tjetër pikë që bashkoi presidentin me përfaqësuesin e PS, që sipas Ballës, disa pseudohistorianë po tentojnë ta bëjnë pis. "Dëshmorët kanë bërë sakrifica të jashtëzakonshme, sublime. Sakrificat që kërkohen sot janë më të thjeshta", deklaroi z.Meta. Kurse Balla u shpreh: "Kush tenton të hedhë baltë mbi Luftën Antifashiste Nacional Çlirimtare, do të marrë përgjigje të ashpër nga ana jonë". Meta e Balla morën pjesë në ceremoninë përkujtimore, ku bashkë me ish-deputetët e LSI u bënë pjesë e disa aktiviteteve të mbajtura në Cërrik.



Presidenti Ilir Meta

**DEKLARATA**

"Pas 22 vitesh, që kur Shqipëria u nda me vitin 1997, që ishte një vit mjaft fatkeq, të gjithë t'i thërrasin mendjes dhe të marrin përgjegjësitë e tyre. Për interesa tërësisht egoiste dhe okulte, Shqipëria nuk ka pse të shkojë në konfrontim, as shqiptarët. Ata kanë vendosur të bashkëjetojnë në mënyrë demokratike dhe janë ndarë me sisteme përjashtuese që në vitin '90"- tha z.Meta.

### "Sulmohen ata që përpiqen të vënë faktet kundër mitit"

## "Armik i popullit", Borchardt: Në politikën shqiptare, hije të së kaluarës

Kreu i Prezencës së OSBE-së iu përgjigj dje akuzave ndaj tij dhe shkrimit në murin e pallatit ku jeton. Madje, ai foli mbi këtë temë në aktivitetin e organizuar nga Autoriteti i Dosjeve për periudhën e diktaturës së proletariatit në Shqipëri, duke përmendur konceptin e "armikut të popullit" dhe mënyrën se si është përdoruar ai nga diktatorë, shkrimtarë apo filozofë. "Sa më shumë nxehet debati, aq më shumë dëgjojmë anatemime në grup të atyre që mendojnë ndryshe. Nuk dëgjojmë argumente kundër pikëpamjeve të tyre. Flitet dhe shkruhet për të zhbërë karaktere dhe jo për fakte apo argumente logjike kundër qëndrimit që ata përfaqësojnë. Refuzohet dialogu me kundërshtarin politik. Sulmohen ata që përpiqen të vendosin faktet kundër mitit", deklaroi z.Bernd Bochardt. Gjashtë ditë pasi në pallatin e tij u shkrua "Shame On You" (Turp të kesh), Bernd Bochardt shprehet se hijet e së kaluarës totalitare janë ende të gjata në Shqipëri. "Tepër aktorë politikë kryesorë herët a vonë përfundojnë duke akuzuar njëri-tjetrin me metaforat dhe retorikën karakteristike për mënyrën sesi metoda e 'armikut të popullit' e kupton politikën dhe jetën publike. Kjo vazhdon ta dëmtojë shoqërinë edhe sot, shumë kohë pasi regjimi politik diktatorial vrastar ka dhënë shpirt, përmes mbajtjes gjallë të perceptimit se një person i vetëm mishëron kombin dhe ka pushtetin të përcaktojë dhe ndëshkojë armiqtë në emër të një nocioni të fabrikuar të moralit, që gjoja rrjedh nga masat", u shpreh Bernd Bochardt.



## "Kambanë alarmi", Kryemadhi të rinjve: Ne dështuam, bëjeni ju Shqipërinë

Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi, në një takim me të rinjtë e kësaj force politike u shpreh dje se klasa politike shqiptare ka dështuar në bërjen e Shqipërisë dhe tashmë të rinjtë duhet të marrin në dorë vendin. "Ju motivojmë më shumë ju, sepse ne dështuam në bërjen e Shqipërisë dhe i vetmi mëkat që duhet të shlyejmë është që t'ju japim forcën juve, guximin dhe kurajën që ta bëni ju Shqipërinë dhe të bëhet ajo Shqipëri që ju e meritoni. E them këtë me bindje të plotë se 30 vitet e transicionit për hir të së vërtetës i kanë kushtuar Shqipërisë, brezave dhe u kanë kushtuar atyre shqiptarëve që nuk janë sot në Shqipëri, por kanë emigruar. Por, mbi të gjitha kanë rrudhur dhe kanë plakur zemrat e nënave shqiptare, të cilat qajnë çdo ditë", deklaroi zj.Kryemadhi. Gjatë takimit, Kryemadhi u ndal jo vetëm te largimi i të rinjve nga vendi, që cilësoi një kambanë alarmi, por edhe te politikat që duhet të ndërmerren për të përmirësuar problematikat e tyre. "Kur merresh me politikë, bëhesh indiferente për problemet e moshës ku nuk ndodhesh vetë. Largimi i të rinjve është kambanë alarmi. Ndërkohë, në anën tjetër statistikat tregojnë se janë 500 mijë shqiptarë që kërkojnë të largohen. Maturantët janë një shtresë shumë energjike dhe shumë e sinqertë në aksionin shoqëror. Kur kthehesh në këndvështrime të tjera, politika bëhet e pavëmendshme", - tha Kryemadhi. Ajo u ndal edhe tek e ardhmja e të rinjve në universitete, teksa shtoi se ka të njëjtin merak edhe për fëmijët e saj. "Unë sot jam 45 vjeçe. Të njëjtat probleme kanë edhe fëmijët e mi, sikurse ju. Kjo, për shkak të moshës", - tha Kryemadhi.



**Nga ana e Shoqerise "Sherbimi Permbarimore AB" Shpk eshte shpallur ankandi faza e dyte per pasurine e meposhtme:**

**1-"Truall + Ndertese"** me siperfaqe truali 5,960 m2 dhe me siperfaqe ndertese 502 m2 me numer pasurie 28/39 rregjistruar ne Rregjistrin Hipotekor Nr.972 date 30.12.2011 e ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr.8571,Volumi 15 Faqe 62 me adrese Lushnje.
**-Çmimi me te cilin fillon ankandi faza e dyte per pasurine e mesiperme eshte 616,000 (gjashteqind e gjashtembedhjete mije) Euro.**

**2-"Truall "** me siperfaqe 4,730 m2 me numer pasurie 28/70 rregjistruar ne Rregjistrin Hipotekor Nr.973 date 30.12.2011 e ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr.8571, Volumi 18 Faqe 143 me adrese Lushnje .
**-Çmimi me te cilin fillon ankandi faza e dyte per pasurine e mesiperme eshte 185,416 (njeqind e tetedhjete e pese mije e katerqind e gjashtembedhjete) Euro.**

**3-"Truall + Ndertese"** me siperfaqe truali 2,400 m2 dhe me siperfaqe ndertese 840 m2 me numer pasurie 28/58 rregjistruar ne Rregjistrin Hipotekor Nr.653 date 25.10.2011 e ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr.8571 ,Volumi 15 Faqe 235 me adrese Lushnje.
**-Çmimi me te cilin fillon ankandi faza e dyte per pasurine e mesiperme eshte 308,350.56 (treqind e tete mije e treqind e pesedhjete pike pesedhjete e gjashte) Euro.**

**4-"Truall + Ndertese"** me siperfaqe truali 4,500 m2 dhe me siperfaqe ndertese 1,535 m2 me numer pasurie 28/69 rregjistruar ne Rregjistrin Hipotekor Nr.431 date 21.06.2013 e ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr.8571 ,Volumi 18 Faqe 142 me adrese Lushnje.
**-Çmimi me te cilin fillon ankandi faza e dyte per pasurine e mesiperme eshte 884,800 (teteqind e tetedhjete e kater mije e teteqind) Euro.**

**Ankandi do te zhvillohet ne date 12.06.2019 ne oren 16:00 prane zyres se shoqerise "Sherbimi Permbarimore AB" Shpk me Permbarues Gjyqesor Privat Admir Beqiri te ndodhur ne adresen Rr.Bul Zhan Dark Pall.Kulla.1Teknoprojekt Shk.1 Kat.4 Ap.10 Tirane.**

**NJOFTIM ANKANDI**

**Shoqëria e Përmbarimit "BAILIFF SERVICE E.HOXHA" sh.p.k** njofton Shpalljen e Ankandit të **I-rë**, për shitjen e pasurisë **ARE** , me sip. **1045 m²**, Zona Kadastrale: 1615 Numri i Pasurisë: 319/24, Vol. 1, Faqe 220, ndodhur në Fier-Shegan Lushnje, në pronësi të: z.Bajram Sefer Skraqi, i datëlindjes 14.11.1967. Ankandi i pasurisë fillon me çmimin fillestar në vlerën **836,000(tetëqind e tridhjetë e gjashtë mijë) LEKË**.
Ankandi do të zhvillohet më datë **22.05.2019**, ora 16:00, pranë zyrës së Shoqërisë së Përmbarimit "BAILIFF SERVICE E.HOXHA" sh.p.k , në adresën Rruga "Vaso Pasha" Pallati 13/1, Ap.1, Tiranë, nr.telefon 042320227, email: elvinth@hotmail.com.

**Publikimi i njoftimit te ankandit te filloj me date 17.05.2018 deri me date 21.05.2019.**

# ISH-PRESIDENTI
## LIBRI


Foto ilustruese

### Përplasja mes dy ish-presidentëve, Topi: Bujari ishte punonjës karburanti

# Topi: E gjeta te pompa e benzinës. Nishani: Hante paçe e pilaf

### "S'do ishe bërë deputet, votat t'i ruajta të paprekura"

Valentina Madani

Ish-presidenti Bamir Topi përmes librit të tij "Nocturn" ka nxitur një përplasje të ashpër me pasardhësin e tij, Bujar Nishani, teksa tregonte si e kishte njohur në një pikë karburanti dhe më pas e kishte futur në PD. Por, për Bujar Nishanin e vërteta është ndryshe. Nishani kundërpërgjigjet se Bamir Topi nuk do mund të ishte bërë dot deputet, nëse nuk do të kishte qenë ai që të ruante të paprekura kutitë e votimit. Nishani e quan Bamir Topin si njeriu me tri karakteristika: gënjeshtar, burracak dhe qelepirxhi. "Bujar Nishanin e kam njohur në një situatë mjaft të veçantë, në një ditë prilli të vitit 2001. Pas mbledhjes së kryesisë së PD-së, ku unë isha anëtar kryesie, po diskutohej ndarja e zonave të kandidatëve për deputetë në qytetin e Tiranës. Në përfundim të mbledhjes, unë u caktova në zonën e 'Xhamllikut', ku përfshiheshin lagje me qytetarë autoktonë, por edhe shumë të ardhur, sidomos në pallatet tek 'Varri i Bamit'. Së bashku me Kujtim Merepezën u nisëm drejt Durrësit dhe në një pikë karburanti pranë Konvaleshencës së Ministrisë së Mbrojtjes tek 'Shkëmbi i Kavajës', shikoj dikë që po furnizonte me karburant një autobus që shkonte drejt jugut. - Kujtim, shko e pyet kush është Bujar Nishani! - thashë unë, ndërkohë që shihja kush do të ishte prej dy punonjësve të pikës. Kujtimi bisedoi me personin në fjalë, afrohet tek unë. - Ai është, por sa të furnizojë autobusin do të vijë! Vërtetë ai erdhi duke kërkuar ndjesë, por edhe me kureshtje se ç'ishte ky takim, ndërkohë që ne nuk njiheshim. - Përshëndetje Bujar! - Përshëndetje! Sigurisht unë ju njoh! - tha Bujari. - Kam ardhur të të bëj një propozim për të punuar me mua për zgjedhjet politike të qershorit dhe për të qenë kryetar i KZAZ-së së zonës 35- i thash. Mbeti disi i hutuar dhe priste ndonjë sqarim më shumë. - Nëse pranon, do të largohesh nga puna, pasi do të jesh çdo ditë në komision! Mendohu dhe më thuaj në telefon. U ndamë për t'u dëgjuar në mbrëmje. Më telefonoi dhe më tha se pranonte dhe kështu nisi bashkëpunimi ynë", - shkruan Topi.


Ish-presidenti Bamir Topi


Ish-presidenti Bujar Nishani

**BAMIR TOPI**
"Së bashku me Kujtim Merepezën u nisëm drejt Durrësit dhe në një pikë karburanti pranë Konvaleshencës së Ministrisë së Mbrojtjes, te 'Shkëmbi i Kavajës', shikoj dikë që po furnizonte me karburant një autobus që shkonte drejt jugut. - Kujtim, shko e pyet kush është Bujar Nishani - thashë unë, ndërkohë që shihja kush do të ishte prej dy punonjësve të pikës", shkruan z.Topi.

**BUJAR NISHANI**
"Kur e kam njohur, fillimisht më vinte keq dhe nuk e kuptoja se përse elita e partisë e përbuzte dhe nuk e afronte. Rrinte gjithmonë i vetmuar te një kioskë përballë selisë së PD-së. Më merrte në telefon dhe fillimisht shkoja t'i bëja shoqëri. Kur pashë se rrinte aty veç të hante një pjatë me paçe e një tas me pilaf dhe largohej pa paguar, mu pështiros", shprehet z.Nishani.

**REAGIMI**

Ish-presidenti Bujar Nishani iu kundërpërgjigj Bamir Topit, i cili në librin e tij "Nocturn" tregon se e ka njohur në një pikë karburantesh dhe e ka afruar ai në PD, duke i kujtuar se shkruan kështu për shkak të inferioritetit: "Duke e njohur mirë atë njeri, që për shkak të kompleksit të thellë të inferioritetit që e karakterizon, është përpjekur gjithë jetën e tij vegjetative të ndërtojë kontraste haluçinante me të tjerët që e mundonin me qenien e tyre. Të punosh pompist nuk është ndonjë gjë e keqe aspak. Kam respektin dhe nderimin tim më të madh për të gjithë ata shqiptarë të ndershëm që bëjnë atë punë. Ajo është shumë më e ndershme se sa psh., t'i ushqesh fëmijët me paratë që u merr si gjoba gjyqtarëve e prokurorëve. Por mua nuk më është dashur të punoj kurrë si pompist. Nëse do ta kisha të nevojshme atë punë, do ta bëja pa asnjë problem. Në fakt, mua më është dashur të punoj në sektorin privat si administrator në tri biznese të ndryshme për disa vite, pasi megjithëse kisha vetëm një vit kur isha kthyer nga studimet pasuniversitare në një prej akademive më prestigjioze në Kaliforni të SHBA-ve, u pushova nga puna në Ministrinë e Mbrojtjes dhe u largova nga Forcat e Armatosura prej ish-enveristëve të Shkollës së Bashkuar, që u rikthyen në krye të asaj ministrie dhe Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë në shtatorin e vitit 1997", shprehet z.Nishani. Ish- presidenti në shkrimin e tij si kundërpërgjigje vë në dukje se fillimisht i është dhimbsur Bamir Topi, por më vonë kishte kuptuar se ai ishte një njeri që "hante pilaf e paçe pa paguar". "I jam drejtuar drejt Bamirit duke i thënë: "Nëse ti i ke votat (84) për t'u zgjedhur president, neve na ke të gjithëve në rresht pas teje, por nëse ti e çon parlamentin drejt shpërndarjes dhe vendin në zgjedhje të parakohshme tri herë radhazi, duhet të marrësh përgjegjësi politike personale! U tmerrua nga kjo që i thashë, u ngrit në këmbë dhe tha se votat duhet t'i gjente Sali Berisha dhe jo ai. Në fakt duheshin një duzinë votash nga socialistët për të kaluar situatën e për këtë duhej kandidat dikush që ishte 'as mish e as peshk', që të mos viheshin në pozitë shumë të rëndë ata socialistë që do të votonin kandidatin tonë për president", tha z.Nishani. Ish-presidenti Nishani tregon gjithë historinë sesi sipas tij ka ndodhur që Topi të bëhej kryetar shteti. "Kur e kam njohur, fillimisht më vinte keq dhe nuk e kuptoja se përse elita e partisë e përbuzte dhe nuk e afronte. Rrinte gjithmonë i vetmuar tek një kioskë përballë selisë së PD-së. Më merrte në telefon dhe fillimisht shkoja t'i bëja shoqëri. Kur pashë se rrinte aty veç të hante një pjatë me paçe e një tas me pilaf dhe largohej pa paguar, mu pështiros. Pronarët e lokalit mund t'ia kishin ofruar 'privilegjin' e paçes dhe pilafit falas, por unë nuk e 'gëlltisja' dot atë sjellje. Ndaj nuk ia vlente që unë t'i kundërvihesha një njeriu që kishte veç tri karakteristika: gënjeshtar, burracak dhe qelepirxhi. Këto janë në fakt karakteristikat e një individi me kompleksin e fortë të inferioritetit, të cilit sot nuk i afrohen as vëllezërit e tij", shprehet z.Nishani.

## ISH-DEPUTETJA

### PD, Tabaku: Betejë pa kompromis kundër krimit

Ish-deputetja e PD-së, Jorida Tabaku, akuzoi dje se maxhoranca socialiste po e bjerr Shqipërinë nga shqiptarët. Tabaku tha se Shqipëria renditet e para në rajon dhe e treta në botë për numrin e azilkërkuesve. "Nga janari i këtij viti deri në mars 6267 shqiptarë që kanë kërkuar azil në vendet e BE-së, ndërkohë që rastet e mbajtura në shqyrtim i kalojnë 10 mijë kërkesa për azil. Sipas statistikave, shqiptarët përbëjnë 4% të totalit prej 55 mijë azilkërkues për marsin 2019. Beteja e Partisë Demokratike është kthimi i besimit tek secili prej nesh. Çlirimi i ekonomisë nga kthetrat e oligarkëve që kanë mbytur ekonominë e tregut duke e centralizuar. Çlirimin e politikës nga inkriminimi dhe betejë e pakompromis ndaj korrupsionit dhe krimit", shkruan Tabaku.

**Shoqeria permbarimore JUSTITIA:**
Shpall ankandin, faza II, për shitjen e pasurisë së paluajtshme per te cilat ka vene hipoteke NBG BANK/ ABI BANK, me këto të dhëna::
· "Are", me siperfaqe 5,130 m², me adrese ne Piraj, Lezhë, , ne Zonën Kadastrale Nr. 2964, me Nr. Pasurie 201/9, Vol. 1, fq. 127, në pronësi te znj. Alma Luigj Marku,
Në vlerën 1.736.000 ( një milion e shtatëqind e tridhjetë e gjashtë mijë ) Lekë.
· "Njësi", me siperfaqe 191 m², me adrese ne Lagjen "Besëlidhja", Lezhë, , ne Regjistrin hipotekor Nr. 578, date 28.10.2016, ne Zonen Kadastraie Nr. 8632, me Nr. Pasurie 4/400-N11, në pronësi të Shoqëria ENCO GROUP sh.p.k
**Në vlerën 75.040 ( shtatëdhjetë e pesë mijë e dyzetë ) EUR.**
**Ankandi zhvillohet në datën 14.06.2019, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përmbaruesit gjyqësor, me Adrese: Bulevardi"Bajram Curri", Pall. 21,Shk. 3, Ap. 18, Tiranë, Shqipëri, web- www.studiojustitia.com, tel. +355 4 2270890**

**Shoqeria permbarimore JUSTITIA:**
Shoqeria permbarimore JUSTITIA shpall ankandin, faza e pare , për shitjen e pasurisë së paluajtshme per te cilen ka vene hipoteke ALPHA BANK, me këto të dhëna:
**Apartament me nr.pas.7/21+1-4 , zk.8360, vol.26 , fq. 204, me sip 138.40 m2, Rruga "Zenel Baboci" Tiranë, në pronësi të z.Gentian Kujtim TOSKU. Cmimi me te cilin fillon ankandi eshte 124.006 Euro ( njëqind e njëzetë e katër mijë e gjashtë eur ).**
Ankandi zhvillohet në datën **30.05.2019,** në përfundim të orarit zyrtar, ora **16:30** në zyrën e përmbaruesit gjyqësor me adrese Bulevardi"Bajram Curri", Pall. 21,Shk. 3, Ap. 18, Tiranë.

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**Zyra permbarimore "Best 2010"**
**SHPALLJE ANKANDIT TE DYTE**
Më datë 06 qershor 2019 nga ora 08.00-ora 16.00 tek kjo zyrë përmbarimore do zhvillohet seanca e fundit e mbledhjes së ofertave për ankandin e II-të, për shitjen e pasurive: a)nr.26/106+1-16, vol.51, fq.242, sip=72 m²; b) Njësi shërbimi nr.26/187-N8/2, vol.56, fq.121, sip=20m²; c) nr.26/187+1-9, vol 52, fq 58 (sip=110 m²); d)nr.26/106+1-25, vol 52, fq 1.
Çmimi fillestar (për pasuritë e lartpërmendura) për njësinë e shërbimit do të jetë 1120 euro/m², ndërsa për tre apartamentet do të jetë 252 euro/m²;
Pronat e lartpërmendura ndodhen në të njëjtin pallat (i ndodhur përballë Teatrit "Petro Marku", Vlorë) që ka ndërtuar Debitori "CO.BE.IN"shpk (NUIS J97201218L)
P.s: Qytetarët/subjektet që dëshirojnë të marrin pjesë në ankand krahas një kërkesë duhet të kenë depozituar dhe 10% të çmimit fillestar si garanci për pjesëmarrje në ankand. Kjo garanci pasurore duhet te jetë e derdhur në BKT, nr.llogarisë Saimir Hoxha PF (IBAN: AL07 2051 2046 4204 98CL PRCLALLA ).
Me adrese : Selia: prapa Prokurorisë së Rrethit Durrës. Mobile: 06920 756 44, Phone/Fax: 052 22 6000. Web: <http://www.permbarues.al/> www.permbarues.al



PS ka kundërshtuar rikthimin e përfaqësuesit demokrat, Kosovrasti në komision

# PD kthehet në KQZ, Biba: S'jeni parti parlamentare, as subjekt zgjedhor

## Komisionerët e PD në KZAZ dhe KQV mund të bllokojnë procesin

Pas vendimit për të çuar komisionerët e vet në Komisionet Zonale të Administrimit Zgjedhor, Partia Demokratike është rikthyer edhe në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Bëhet fjalë për kthimin në tryezën e vet të përfaqësuesit ligjor të PD-së Niazi Kosovrasti dhe jo të anëtarëve që duhet të kishte propozuar PD si anëtar të këtij komisioni. Por rikthimi i Kosovrastit në KQZ ka sjellë dhe debate, pasi të zgjedhurit e majtë në këtë komision kanë kundërshtuar, duke theksuar se prezenca e përfaqësuesit të PD-së në radhën e përfaqësuesve të subjekteve zgjedhore nuk është i ligjshëm. Nënkryetari i KQZ-së, Denar Biba kundërshtoi gjatë këtë prani të Kosovrastit duke theksuar se ai përfaqëson një parti që nuk është më as parlamentare dhe mbi të gjitha nuk është subjekt zgjedhor. Në fakt, gjithë debati lindi nga parashtrimi i një sërë pyetjesh nga ana e Kosovrastit lidhur me procesin e deritanishëm të administrimit të zgjedhjeve. "Momenti i rëndësishëm në verifikimin e firmave është marrja e kampionit prej 5 për qindësh nëse i plotësojnë kushtet e kodit apo jo", - tha Kosovrasti. Por këtij shqetësimi të tij i është përgjigjur Biba, i cili theksoi se interesi i PD-së për atë që ndodh në këtë tryezë, por edhe në gjithë procesin e administrimit të zgjedhjeve është zero. "Duke mos qenë subjekt zgjedhor interesi juaj me atë që ndodh këtu është një me gazetarët ose me çdo qytetar tjetër. Ju nuk keni një interes të posaçëm në lidhje me këto", - tha Biba. Por Kosovrasti ka këmbëngulur se PD është parti parlamentare dhe kjo sipas tij përcaktohet nga rezultati i zgjedhjeve të shkuara. "Pa diskutim që jemi parti parlamentare dhe kuptimi i partisë parlamentare përcaktohet nga rezultati i zgjedhjeve të radhës që janë kryer", - tha Kosovrasti. Ndërkohë që Biba këmbënguli se PD mandatet e fituara i ka dorëzuar dhe ky sipas tij është një fakt i njohur publikisht. "Partia Demokratike ka një marrëdhënie të shkëputur nga Kuvendit aktualisht dhe është fakt i njohur publik", - tha Biba. Lidhur me këtë pretendim Kosovrasti u shpreh se KQZ duhet të marrë vendim që PD të mos jetë e pranishme. Diçka që përfaqësuesit e majtë në KQZ nuk e bën, duke mos dashur të nxisin edhe më tej konfliktin dhe mosmarrëveshjet politike në vend. Ndërkohë që paralelisht me këtë PD ka nisur të përzgjedhë komisionerët e KZAZ-ve për të plotësuar vendet që i përkasin në bazë të Kodit Zgjedhor. Ndonëse nuk është regjistruar në zgjedhje, PD ka vendosur që të jetë prezentë në procesin e administrimit të zgjedhjeve duke pretenduar se deri më tani këto komisione duke përfituar nga mosprania e opozitës kanë bërë shkelje të shumta sidomos regjistrimin e kandidatëve. Por ky veprim i saj ka trembur socialistët, të cilët i ndruhen një përdorimi të këtyre komisionerëve për të prishur zgjedhjet ditën e votimit. Kështu PD mund t'i përdorë ata në ato duke bllokuar vendimmarrjen në ato komisione ku opozita ka shumicën, ose mund të t'i përdorë edhe duke marrë vulat me të cilat fletët e votimit duhet të vulosen për të qenë të vlefshme në proces numërimi. Por PD nga ana e saj i ka mohuar këto skenarë, duke theksuar se çdo gjë bëhet për të kontrolluar procesin nga brenda.




### Rama: Kush ka zgjedhur të dëmtojë, është i dënuar të dështojë

Kryeministri Edi Rama ka deklaruar dje se opozita është destinuar të dështojë me aktetet e saja të dhunës ndaj institucioneve dhe se nuk do të mundet dot ta detyrojë qeverinë dhe institucionet shtetërore të dorëzohen para saj. Përmes një postimi në 'Facebook' ku ka publikuar disa foto nga puna për të pastruar fasadën e dëmtuar gjatë protestave të opozitës, kryeministri Edi Rama është shprehur se qeveria është e dënuar të durojë dhe të vazhdojë përpara. "Kush ka zgjedhur të shëmtojë e të dëmtojë, është i dënuar të turpërohet e të dështojë. Kush ka zgjedhur të pastrojë e të ndërtojë, është i dënuar të durojë dhe të vazhdojë" - shkruan Rama në 'Facebook', bashkëngjitur fotove.

### U përballën me protestat, qeveria shpërblen me një pagë policët

Forcat e Policisë së Shtetit kanë qenë shpesh herë kohët e fundit gjatë protestave të opozitës nën breshërinë e goditjeve me mjete të forta dhe deri te bombat molotov, duke rrezikuar shpesh herë edhe jetën. Një pjesë e vogël e tyre edhe janë plagosur ndërsa janë dërguar në spital për t'u mjekuar. Ndaj për kontributin që kanë dhënë në menaxhimin e situatave të vështira në këto protesta, por edhe duke treguar durim para protestuesve, qeveria ka vendosur t'i shpërblejë ata financiarisht. Për këtë qëllim Këshilli i Ministrave me propozim të Ministrit të Brendshëm ka miratuar vendimin për shpërblimin me një pagë mujore të një pjesë të policave për rezultate të larta në punën e tyre. Në vendimin e publikuar në Fletoren Zyrtare përcaktohet se në buxhetin e miratuar për vitin 2019 Ministrisë së Brendshme t'i shtohet fondi prej 170 000 000 (njëqind e shtatëdhjetë milionë) lekësh, në programin buxhetor "Policia e Shtetit", për shpërblimin e punonjësve të Policisë së Shtetit, për rezultate të larta në kryerjen e detyrës, fond ky që do t'i hiqet buxhetit të Ministrisë së Mbrojtjes. Masa e shpërblimit të jetë deri në një pagë mujore dhe lista e punonjësve të Policisë së Shtetit, që do të shpërblehen, do të miratohet nga ministri i Brendshëm, me propozim të drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **“Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes dhe riparimit të ashensorëve në godinat e Bankës së Shqipërisë”**

‘Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit “Tender i hapur kombëtar”, për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 1,840,000 Lekë”**.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi “Halili”, Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 1844), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkese me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfituesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: “**Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes dhe riparimit të ashensorëve në godinat e Bankës së Shqipërisë”**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 10 Qershor 2019, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **“Blerje pjesë këmbimi, mirëmbajtje dhe riparim i automjeteve të Bankës së Shqipërisë për një periudhë një vjeçare”**

‘Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit “Tender i hapur kombëtar”, për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 4,000,000 Lekë”**.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi “Halili”, Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 1844), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkese me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfituesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: “**Blerje pjesë këmbimi, mirëmbajtje dhe riparim i automjeteve të Bankës së Shqipërisë për një periudhë një vjeçare”**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 10 Qershor 2019, ora 14:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

27-vjeçari ishte dënuar më parë për falsifikim vizash e pasaportash

# Bastisi 25 banesa në Gjermani për 3 vjet, kapet dibrani i shpallur në kërkim europian

## *Operacioni "Anti-Skifter", arrestimi në bazë të letër-porosisë së autoriteteve gjermane*

Një 27-vjeçar nga Dibra, i akuzuar për dhjetëra vjedhje në Gjermani është arrestuar dje nga Policia e Shtetit në bashkëpunim me autoritetet gjermane. Pas një pune të mirorganizuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë dhe Task Forca "Anti-Skifter" në bashkëpunim me Drejtorinë e Forcës së Posaçme Operacionale si dhe komisariatin e policisë Durrës, u bë identifikimi, kapja dhe ndalimi i shtetasit shqiptar, A.L., 27 vjeç, lindur në Dibër dhe banues në Durrës. Ky shtetas ishte person i shpallur person në kërkim europian, i dënuar më parë për veprën penale "Falsifikimi i letërnjoftimeve i pasaportave apo i vizave", person nën hetim, i dyshuar për kryerjen e veprës penale "Vjedhja", kryer në kuadrin e "Grupit të strukturuar kriminal". Burime zyrtare nga policia bënë me dije se ndalimi u bë në zbatim të letër-porosisë së organeve ligjzbatuese gjermane, pasi u regjistrua procedimi penal nr. 39/ viti 2019, në Prokurorinë për Krime të Rënda Tiranë. Mësohet se i riu në bashkëpunim me persona të tjerë ka kryer rreth 25 vjedhje banesash në rajonin Bochum, Gjermani, ku kanë përvetësuar sasi të konsiderueshme parash, bizhuteri, orë të markave të shtrenjta, pajisje elektronike etj. Gjatë kontrollit të banesës së tij u sekuestruan disa dokumente për transferta parash nga Gjermania në Shqipëri, orë të markave të shtrenjta, telefona celularë, bizhuteri si dhe një automjet. Në bashkërendim me organet ligjzbatuese të rajonit të Bochumit, Gjermani, Task Forca "Anti-Skifter" dhe Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë po vijon puna për dokumentimin e plotë ligjor të aktivitetit kriminal të këtij grupi të strukturuar, ku deri tani është provuar se ka kryer 25 vjedhje banesash, por dyshohet se ka kryer edhe vjedhje të tjera në këtë rajon. Aktiviteti kriminal i këtij grupi shtrihet në periudhën kohore 2015-2018 në dhjetë rajone në Gjemani. Policia gjermane ka bashkëpunuar me Task Forcën "Anti-Skifter" dhe më pas nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, ku dhe është regjistruar procedimi penal. Në tetor të vitit 2018, pas bashkëpunimit të suksesshëm të organeve ligjzbatuese të Gjermanisë me policinë shqiptare u bë i mundur të identifikohet dhe të arrestohet shtetasi shqiptar G.SH., si pjesëtar i këtij grupi kriminal. Në fillim të muajit maj 2019 në Prokurorinë e Bochum, Gjermani, është zhvilluar një takim pune ndërkombëtar ndërmjet organeve ligjzbatuese të prokurorive dhe policive respektive të të dyja vendeve, ku u përcaktuan detyra të përbashkëta policore dhe procedurale, me qëllim dokumentimin ligjor të aktivitetit kriminal të të gjithë anëtarëve të këtij grupi dhe sidomos të shtetasit shqiptar A.L., i cili kishte mundur të largohej nga Gjermania. Goditja e këtij grupi kriminal u publikua edhe në mediat gjermane, duke cituar prokurorët dhe oficerët e Policisë Gjyqësore gjermane, se Shqipëria prej disa vjetësh po vepron me forcë kundër krimit të organizuar dhe sidomos krimit të organizuar kundër pronës. Operacioni "Anti-Skifter" vazhdon në bashkëpunim me organet ligjzbatuese të Gjermanisë dhe vendeve të tjera të BE-së.


Materialet e sekuestruara në banesën e 27-vjeçarit

**SEKUESTRIMI**

Mësohet se i riu në bashkëpunim me persona të tjerë ka kryer rreth 25 vjedhje banesash në rajonin Bochum, Gjermani, ku kanë përvetësuar sasi të konsiderueshme parash, bizhuteri, orë të markave të shtrenjta, paisje elektronike etj. Gjatë kontrollit të banesës së tij, iu sekuestruan disa dokumenta për transferta parash nga Gjermania në Shqipëri, orë të markave të shtrenjta, telefona celularë, bizhuteri si dhe një automjet.

## Të dënuar për trafik droge e vjedhje, kapen dy në Vlorë e Sarandë




Policia e Sarandës dhe Vlorës ka ndaluar dy persona të shpallur në kërkim për trafik droge dhe vjedhje. Sipas të dhënave zyrtare, është ndaluar shtetasi i shpallur në kërkim, H.Xh., 41 vjeç, banues në fshatin Bregas, Finiq. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë i ka vendosur masën e sigurisë "Arrest në burg" për arsye të njehsimit të vendimit të gjykatës greke, e cila në vitin 2015 ka dënuar këtë shtetas me 12 vite burg për veprën penale "Trafikimi i narkotikëve". Po kështu, shërbimet e policisë së Selenicës kanë bërë të mundur kapjen dhe ndalimin e shtetasit të shpallur në kërkim, A.M., 29 vjeç, banues në fshatin Rexhepaj, Selenicë. Kapja dhe ndalimi i këtij shtetasi u bë për arsye se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me anë të dy vendimeve në 2014 dhe 2016 e ka dënuar këtë shtetas me 3 vite e 2 muaj burgim për veprat penale "Vjedhja me dhunë" dhe "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe atyre sportive".



## Pranga shqiptarit në Itali, grabiste banesat e italianëve

**ITALI** - Është arrestuar në Itali 27-vjeçari shqiptar Klodian Nikolli, i quajtur nga mediat fqinje si "Doktor K". Shqiptari maskohej si një student në Universitetin e Boçoni dhe madje kishte postuar në rrjetet sociale se ishte diplomuar, diplomë e cila rezultoi false. Ai ishte i specializuar në vjedhjet e shtëpive luksoze dhe në muajin shkurt u dënua me arrest shtëpie, por menjëherë u zhduk. Pas tre muajve në arrati, ndoshta duke vjedhur e bastisur shtëpitë luksoze, Nikolli u vu sërish në pranga. Në shtëpinë e tij u gjendën piktura të piktorëve të shekullit të 20-të, orë luksoze dhe madje unaza me diamante, të gjitha të vjedhura në shtëpitë në Milano.

## SHKURT

### Kokainë në këpucë, kapet shpërndarësi i drogës

**FIER** - Një shpërndarës droge ka përfunduar në pranga, ndërsa gjatë kontrollit në banesë i janë gjetur 15 doza kokainë të fshehura në këpucë. Seksioni për Hetimin e Narkotikëve në Drejtorinë Vendore të Policisë Fier, në bazë të informacione të siguruara në rrugë operative se një shtetas merrej me shpërndarje të drogave të forta në doza të vogla, organizuan punën duke finalizuar operacionin e koduar "Kristali". Si rezultat i operacionit, gjatë kontrollit të banesës së shtetasit L.Ç., policia gjeti dhe sekuestroi në cilësinë e provës materiale 15 doza me lëndë narkotike të dyshuar kokainë. Në përfundim të veprimeve të para hetimore u bë arrestimi në flagrancë i shtetasit, L.Ç., 37 vjeç, banues në Fier. Materialet procedurale do t'i kalojnë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier për veprime të mëtejshme hetimore, për veprën penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve".

### Lojërat e fatit, procedohen penalisht dy persona

**BERAT** - Policia e Beratit ka ushtruar kontrolle për goditjen e veprimtarisë së kundraligjshme të lojërave të fatit dhe ka proceduar penalisht 2 shtetas, pasi ushtronin aktivitetin e kundraligjshëm. Bëhet fjalë për shtetasit E.T., 60 vjeç; M.Q., 28 vjeç, të dy banues në Berat. Procedimi penal i këtyre shtetasve u bë për veprat penale "Organizim i lotarive të palejuara", "Fshehja e të ardhurave", "Punësim i paligjshëm", "Vënia në dispozicion e lokaleve për lojëra të palejuara" pasi në ambientin e lokalit, në pronësi të shtetasit E.T. ushtronin aktivitetin e kundraligjshëm të lojërave të fatit. U sekuestruan në cilësinë e provave materiale 1 valixhe e mbushur me çipsa, 1 tavolinë pokeri, 2 pako me letra bixhozi si edhe 11.700 lekë.

### E zë korrenti në shtyllë, humb jetën elektricisti

**DURRËS** - Një ngjarje e rëndë raportohet se ka ndodhur në Rrashbull të Durrësit, ku një elektricist ka rënë në kontakt me rrymën elektrike dhe për pasojë ka ndërruar jetë. "Më datë 17.05.2019, rreth orës 12:50, në Rrashbull, shtetasi K.Xh., 35 vjeç, banues në Durrës, elektricist, duke riparuar një defekt elektrik në një shtyllë ka rënë në kontakt me energjinë elektrike dhe për pasojë ka ndërruar jetë. Grupi hetimor ndodhet në vendngjarje dhe po punon për sqarimin e plotë të rrethanave të ngjarjes", njoftoi policia.

# Fshehu dënimin në Itali, prokuroria kërkon 1.6 vite burg për ish-gjyqtarin Admir Thanza

**TIRANË** - Një vit e gjashtë muaj burg ka kërkuar Prokuroria e Tiranës për Admir Thanzën, ish-anëtarin e Gjykatës së Lartë, i shkarkuar nga vetingu. Ai akuzohet falsifikim dokumentesh, pasi ka fshehur një dënim për vjedhje të bërë në Itali, në vitin 1999. Në pretencën e lexuar nga prokurori sqarohet se ish-gjyqtari në bashkëpunim dhe me dy shtetas të tjerë në një supermarket kanë vjedhur



produkte kozmetike dhe rroba. Ai është arrestuar dhe më pas është gjykuar në gjendje të lirë në Piza. Në përfundim të procesit, ai u dënua me 40 ditë heqje lire dhe 100 mijë lireta gjobë, dënim i cili i është pezulluar. Këtë informacion Thanza sipas prokurorisë nuk e deklaruar në formularin e dekriminalizimit, duke u përgjigjur se nuk ka qenë asnjëherë i dënuar. Ish-gjyqtari nuk e ka pranuar akuzën gjatë hetimit, duke sqaruar se çdo veprim i prokurorisë bie ndesh me ligjin dhe kushtetues. Në seancën e vetingut Thaza dha një tjetër version për ngjarjen e 20 viteve më parë. Sipas tij, autore e vjedhjes ishte ish-kunata e tij, e cila së bashku me të ndodhej në Itali, pasi nipi vuante nga një sëmundje e rëndë dhe ndodhej për kurim atje. Thanza tha se gruaja e vëllait të tij kreu vjedhjen, por duke qenë se ajo duhej të kujdesej për djalin, e mori ai përgjegjësinë për ngjarjen.

"Do të shtojmë masat dhe vigjilencën ndaj luftës kundër kultivimit të drogës"

# Ministri Sandër Lleshaj: Kush saboton votimin, do të japë llogari para ligjit

## *"Për protestat, policia do të reagojë një shkallë më poshtë në nivelin e dhunës dhe 0 viktima"*

**KORÇË**

*Ministri i Brendshëm, Sandër Lleshaj, ka folur nga Korça për zgjedhjet e 30 qershorit, për të cilat tha se do të mbahen, duke nënvizuar përgjegjësitë e policisë për këtë proces. Në një takim me strukturat vendore të policisë, ai tha se policia do të marrë të gjitha masat që zgjedhjet të zhvillohen me parametrat e kërkuara. Ndër të tjera, Lleshaj theksoi se kush do sabotojë votimin, do të japë llogari para ligjit. "Për arsye se kështu e kërkon Kushtetuta dhe ndalimi i tyre nuk është atribut i kurrkujt, askush nuk mund t'i ndalojë zgjedhjet, zgjedhjet janë të qytetarëve shqiptarë. Sigurisht që nëse do të ketë njerëz që do të dalin nga kufijtë e arsyes dhe të ligjit, patjetër që organet përkatëse të sigurisë dhe të ligjzbatimit do të marrin masat e duhura. Plane ka për gjithçka", tha Lleshaj.*



Ministri i Brendshëm, Sandër Lleshaj

**Zoti ministër, në datën 25, opozita ka lajmëruar sërish për një protestë të opozitës së bashkuar. Gazi lotsjellës do të përdoret po aq fuqishëm sa në protestat e tjera?**

**Si përfundim, çdokush ka një muzë (moto) apo shprehje nga e cila frymëzohet çdo ditë. Cila është e juaja?**

Realisht nuk kam një moto të caktuar, por frymëzimi im i përditshëm është: Puna e pa ndalur dhe përkushtimi i madh ditë pas dite për muzikën të cilën e bëj me zemër. Por gjithmonë kam preferuar të eci me këtë thënie "successful people are not gifted, they just ëork hard, and than succeed on purpose."(Njerëzit e suksesshëm nuk janë me fat, ata thjesht punojnë fort dhe kanë sukses me qëllim).

# Robert Berisha ndahet nga Nora Istrefi? Këngëtari reagon: Është normale!

Roberti, partneri i këngëtares Nora Istrefi ka sqaruar tashmë gjithçka. "Ndarja është normale për një çift që vendos t'i japë fund marrëdhënies!" Kështu është shprehur Robert Berisha në një intervistë për emisionin e mëngjesit "Gjesi" në T7. Kur u pyet në lidhje me lajmet që kanë qarkulluar shpesh për raportin e tij me Nora Istrefin, Roberti tha se mediat priren të publikojnë menjëherë lajmet e këqija. Megjithatë ai u shpreh se nëse ndarja ndodh, kjo është diçka normale që duhet të pranohet. Kjo nuk duhet të merret sikur vërtet po ndodh në raportin e tij me Norën."Nëse ka diçka të vërtetë, shumë shpejt merret vesh. Edhe është diçka normale edhe nëse është e vërtetë. Është shumë gjë normale", është shprehur këngëtari. "Për t'i qetësuar të gjithë, s'ka asgjë të vërtetë në ato që po shkruhen, apo jo?", e pyet moderatorja. "Jo jo, shëndoshë e mirë, çdo send është në rregull."- është përgjigjur Roberti. "A e ke parë, të këqijat merren vesh shpejt, të mirat s'i besojnë njerëzit", u shpreh Roberti.





**Rrëfehet bukuroshja shqiptare: Kemi shumë oferta në Japoni e Itali, si motra binjake marrim pjesë bashkë**

# Zgjidhet më e bukura e Australisë, Klea Hanson (Mema): S'mjafton paraqitja, por zgjuarsia dhe të ndihmosh njerëzit

Pamela Aliaj

*"Mirësia është e lirë që ta përhapesh atë kudo!"*







Bukuria dhe talenti nuk qëndron vetëm brenda kufijve, por shumë shpesh arrin që të çajë e të ketë sukses edhe jashtë vendit. Në këtë rast ka arritur deri në Australi ku një bukuroshe me prindër shqiptarë ka arritur të rrëmbejë kurorën e më të bukurës së këtij kontinenti. Ajo quhet Klea Hanson, por mbiemri shqiptar i prindërve është Mema. Në një intervistë ekskluzive për "Bluetooth" të "Gazeta Shqiptare" bukuroshja nga Lezha na rrëfen gjithçka rreth saj dhe pasioneve që ajo ka lidhur me botën e modës dhe jo vetëm. Një detaj i bukur është se ajo ka një motër binjake dhe të dyja bashkë janë pjesëmarrëse në shumë projekte modelingu nëpër botë, nga Japonia në Itali. Edhe pse e lindur e rritur në Australi, Klea ka arritur ta përvetësojë gjuhën shqipe nëpërmjet gjyshes së saj që jeton këtu.

"Herën e parë kur kam ardhur në Shqipëri kam qenë 13 vjeç. Tanimë vij edhe më shpesh. Në Shqipëri më pëlqen më tepër Lezha dhe Shëngjini, sepse rri më shumë tek nëna. Por më pëlqen e gjithë Shqipëria në tërësi. Kam shumë kontakt me gjyshen time në Shqipëri, kështu që më ka mësuar më shumë gjyshja", thotë Klea.

**Por pasioni i saj nuk ndalet me modelingun dhe bukurinë, por shkon më tej. Bukuroshja përfaqësuese e Australisë është në universitet për psikologji dhe ëndrrat e saj për të ardhmen janë të shumta.**

"Unë studioj për psikologji. Jam në vitin e tretë bachelor. Në të ardhmen e shoh veten duke u marrë me studimet mjeko-ligjore. Dhe me konkurse apo shfaqje të ndryshme. Por dëshira ime më e madhe është që një ditë të hap një azil për të ndihmuar njerëzit e moshuar në Shqipëri.", rrëfen bukuroshja.

Për ta njohur më tepër më të bukurën e Australisë ndiqni intervistën e mëposhtme.

**Mbani kurorën e miss Australia, por me prejardhje shqiptare: E prisnit të fitonit këtë titull?**

Unë kam lindur në Australi, por babin edhe mamin i kam shqiptar. Pse jo?!! I kam patur shanset si të gjithë vajzat e tjera.

**Si u ndjetë që u përzgjodhët më e bukura e këtij vendi?**

Kam qenë shumë e gë-





zuar, sepse në Australi nuk mjafton vetëm të jesh e bukur. Duhet të jesh e zgjuar dhe të ndihmosh njerëzit që kanë nevojë.

**Keni linja perfekte dhe jeni tepër tërheqëse. Keni dashur të jeni gjithmonë pjesë e modelingut?**

Shumë faleminderit! Jam marrë me modeling që e vogël me motrën time binjake, po kur kam hyrë në universitet e lash për pak kohë.

**Si lindi ideja për të konkurruar?**

Më kanë thanë shoqet që të marr pjesë!

**Ju jeni lindur e rritur në Australi. Si është historia e familjes suaj?**

Babi im ka shkuar në Australi para 30 viteve, për një jetë më të mirë. Por u kthye prap në Shqipëri për pushime, pas 5 viteve, edhe u njoh me mamin. Më vonë u kthyen sërish në Australi dhe vijuan jetën këtu.







**Sa të vështire e kanë patur, si të huaj, për t'u përshtatur në një vend si Australia?**

Unë s'jam e huaj, ndihem rehat. Por prindërit, natyrisht si gjithë shqiptarët e tjerë që emigrojnë, kalojnë vështirësitë e tyre. Fillimi gjithmonë është i vështirë për këdo.

**Për çfarë studioni? Ku e shihni veten në të ardhmen?**

Unë studioj për psikologji. Jam në vitin e tretë bachelor. Në të ardhmen e shoh veten duke u marr me studimet mjeko-ligjore. Dhe me konkurse apo shfaqe të ndryshme. Por dëshira ime më e madhe është që një ditë të hap një azil për të ndihmuar njerëzit e moshuar në Shqipëri.

**Cili është pasioni tjetër i Kleas përveç modelingut?**

Më pëlqen hiking (të ec në mal) dhe muzika.

**Si ia kanë dalë prindërit për të ruajtur kulturën dhe gjuhën për t'jua përçuar ju, fëmijëve?**

Kam shumë kontakt me gjyshen time në Shqipëri, kështu që më ka mësuar më shumë gjyshja.

**Cili është personi që ju nxit dhe ju ndihmon për të arritur më të mirën tuaj?**

Babi dhe mami im, të dy janë mbështetja ime më e madhe.

**Keni qenë ndonjëherë në Shqipëri? Në vendlindjen e prindërve?**

Herën e parë kur kam ardhur në Shqipëri kam qenë 13 vjeç. Tanimë vij edhe më shpesh.

**Cili është qyteti që ju pëlqen më tepër?**

Në Shqipëri më pëlqen më tepër Lezha dhe Shëngjini, sepse rri më shumë tek nëna. Por më pëlqen e gjithë Shqipëria në tërësi.

**A keni patur oferta modelingu apo të keni qenë pjesëmarrëse në projekte të ndryshme?**

Po kam pas shumë oferta në Japoni dhe Itali, se jemi dy motra binjake që shkojmë e marrim pjesë. Është e veçantë të jenë të dyja njësoj, kështu që kemi më shumë oferta. Por dëshira e babit tim është që të mbarojmë universitetin, kështu që është prioriteti im i parë.

**Po duke qenë se jeni binjake dhe të dyja modele, pse nuk mori pjesë në konkursin e bukurisë dhe motra juaj?**

Ajo studion për juridik dhe nuk para i pëlqejnë këto lloj konkursesh, kështu që shkova vetëm unë.

**Çfarë ndryshimi ka kultura shqiptare me atë australiane? Ku e gjen veten më tepër Klea?**

Nuk di si ta përkufizoj, por në Australi njerëzit janë shumë të thjeshtë, është gjë shumë e mirë. Por në Shqipëri më pëlqen fakti që njerëzit janë më të dashur. Por i dua të dyja kulturat. S'ka rëndësi sepse tek të dy vendet jam gjithmonë vetvetja.

**Cila është shprehja që ju frymëzon më tepër dhe e përdorni çdo ditë?**

"Kindness is free sprinkle that stuff everyëhere," që në shqip do të thotë "Mirësia është e lirë që ta përhapesh atë kudo!"

# Krenari uron publikisht Marinën për ditëlindje, fansat e ngacmojnë: Si i ke punët me Luanën?



Partneri i shumëpërfolur i moderatores, Luana Vjollca, Krenar Çoçaj është bërë i gjallë më në fund! Edhe pse marrëdhënien e tij me Luanën po e mban të fshehtë në mënyrë hermetike, ai nuk ka ngurruar të urojë publikisht Getoarin për ditëlindjen e bashkëshortes së tij! "Urime ditëlindja e gruas! U plakshi bashkë me të gjitha të mirat!", shkruan Krenari në postimin e Getoarit për ditëlindjen e partneres. Komenti i tij është vënë re menjëherë nga fansat, të cilët janë bërë kuriozë për të ditur sesi po i ecin punët me Luanën. Duke qenë se marrëdhënia e tyre po mbahet e fshehur, kurioziteti i fansave të moderatores sa vjen edhe rritet! Shpresojmë të mësojmë diçka më shumë për çiftin edhe pse mesa duket fshehtësia po u shijon më shumë të dyve dhe nuk parapëlqejnë të përfliten kot.



# Në linja perfekte! Adelina Tahiri tregon sa kilogramë ka humbur pas lindjes

Këngëtarja e njohur, Adelina Tahiri është mjaft aktive në rrjetet sociale. Si para dhe pas lindjes së djalit këngëtarja shqiptare ka ndarë me të gjithë ndjekësit etapat e ndryshme të mëmësisë. Artistja shqiptare nuk e ka pasur problem të flasë publikisht edhe për kilogramët e shumtë që shtoi gjatë shtatzënisë. Pak kohë më parë ajo tregoi se kishte shtuar 27 kilogramë. Megjithatë pas një "lufte" të gjatë me dita dhe palestër duket se tani Adelina ka arritur peshën ideale. Ditën e djeshme ajo ka publikuar një foto të trupit dhe format e saj fizike duken perfekte. Në fotografi ajo shfaqet e tonifikuar dhe me bel shumë të hollë, njësoj si para lindjes së djalit. "Po deshët besoni, po deshët jo, nga 84.8 kilogramë jam 58 kilogramë", ka treguar Adelina gjithë krenari.









# E kapëm mat! Capital T shihet në makinë me një vajzë dhe mund të jetë e dashura

Ai është një nga reperët më të dashur për publikun shqiptar. Edhe pse ai ka vite në tregun muzikor shqiptar dhe është një ndër emrat më të lakuar, për sa i përket jetës së tij private nuk dihej thuajse asgjë deri më sot. Kjo pasi së fundmi, portali "arbresh.info" ka siguruar një foto të shkrepur mbrëmjen e enjte, ku Capital T, shihet në një makinë luksoze përkrah një vajze bukuroshe. Por teksa dyshohet se vajza brune mund të jetë e dashura e re e reperit që është hermetik për sa i përket jetës së tij sentimentale, ende nuk dihet asgjë për identitetin e saj. Në foton në fjalë, dyshja shihet duke qeshur, me siguri të pavetdijshëm se përballë dikush po i fotografonte. Megjithatë, mbetet për t'u parë nëse Capital T do ta komentojë këtë foto, që duket të jetë hera e parë që e shohim reperin pranë një "të dashure potenciale".





# "Po gjoksin ku e le?" Emina i jep përgjigjen epike ndjekëses në 'Instagram'

Modelja bukuroshe Emina Cunmulaj ka publikuar së fundmi një foto nga udhëtimi me avion privat drejt New Jersey-t. Modelja është rehatuar në kolltukun e rehatshëm teksa pozon e veshur e gjitha me të zeza. Elegante si gjithnjë, Emina duket e veshur shumë thjeshtë ndërsa në brez mban një çantë në kuqe. Por si gjithnjë, kritikat nuk mungojnë në fotot e saj, dhe aq më tepër nga ndjekëset femra. Madje njëra prej tyre ka komentuar gjoksin e vogël të Eminës. "Po gjoksin ku e le?", i shkruan ajo në 'Instagram'. Emina nuk e ka lënë pa një përgjigje dhe i është kthyer menjëherë me një koment epik në 'Instagram': "Aty në aeroplan privat e kam lënë. Mos u bëj merak motra se ai gjoks ka ushqyer dy fëmijë!" Modelja tregohet gjithnjë e drejtpërdrejtë me ndjekëset dhe shpesh u përgjigjet kritikave dhe çdo fyerje që has për veten apo familjen e saj.

# Çfarë ndodhi? Arbenita dhe Fero tregojnë të vërtetën e ndarjes së tyre

Fero dhe Arbenita Ismajli janë bashkë apo janë ndarë? Tanimë, pas gjithë asaj buje që bënë së fundmi me lajmin për ndarjen, u kuptua e vërteta. Në fillim ishte Fero ai i cili që prej mëngjesit të djeshëm publikoi një status në 'Instastory', ku shkruante: "U zgjova këtë mëngjes dhe përshëndetje vajza nga sot e tutje jam beqar!" Më pas modelja seksi Arbenita, publikoi foton e një emoji duke qeshur me lot, dhe ky postim na bëri të dyshojmë se dyshja thjesht po bënin shaka! Por Arbenita e fshiu më pas postimin duke i bërë fansat të dyshojnë se diçka ka ndodhur, të paktën deri më sot kur sqaroi gjithçka! Modelja ka publikuar një deklaratë në lidhje me gjithë situatën e krijuar për të thënë:" E hëngrët keq!" Ajo ka treguar se jo vetëm që nuk është ndarë nga Fero, por marrëdhënia e tyre është e shkëlqyer! "Urrejtja është e vërtetë! Njerëzit urrejnë kur ti ecën mirë dhe ke një marrëdhënie të shkëlqyer. E hëngrët keq! Përpjekje e bukur të gjithë atyre djem dhe vajza që na shkruan në DM", shkruan Arbenita. Të njëjtin postim ka publikuar edhe Fero në 'Instastory', duke mos i hequr asnjë pikë apo presje kësaj deklarate! Mirë, tanimë e dimë që janë thjesht shaka postimet e tyre dhe janë më të lidhur se kurrë bashkë. Lajm i mirë apo jo?






KONFERENCA





# Të gjitha fytyrat e "armikut të popullit", historianët hapin arkivat

Fatmira Nikolli




*Mbahet konferenca ndërkombëtare shkencore për diktaturën e proletariatit në Shqipëri, 1944-1990*

Që pas rënies së perdes së hekurt e në ditët e sotme, kur debati publik mbi të kaluarën është i nxehtë e me raste me tone të larta, qasja e zakonshme ndaj sjelljeve të caktuara, krimeve, akteve të dhunës, keqtrajtimeve apo mbështetjes së regjimit është relativizuar nëpërmjet shprehjeve të njohura: "ashtu ishte koha", "ashtu thoshte ligji", "çdo gjë është kryer në zbatim të ligjit", duke sjellë për pasojë qëndrime të ngurta, përballë një shteti që paska qenë i mirorganizuar me ligje të drejta dhe ata që e kundërshtuan, ishin thjesht shkelës të ligjit". Genta Sula, kryetare e Autoritetit të Dosjeve e nisi me këtë konstatim fjalën e saj në konferencën shkencore ndërkombëtare "Armiqtë e Popullit", organizuar prej Autoritetit me pjesëmarrjen e rreth 30 studiuesve. Sipas saj, pretendimet nga ana tjetër, janë se ata që e mbështetën, konsoliduan, i dhanë jetë e pushtet instrumenteve drejtuese, kontrolluese, ishin thjesht njerëz që bënin punën, të rregulluar me ligj e procedura dhe si të tillë, të çliruar nga çdo përgjegjësi zyrtare, njerëzore, personale, morale, për çdo veprim të kryer në detyrë, ose jo. "Për rrjedhojë, mjafton të zbatoje ligjin, të bëje kujdes me shprehjen e mendimeve dhe të ideve, të respektoje vijën ideologjike dhe mund të jetoje i qetë, i vetëcensuruar dhe i kujdesshëm. Këtu nis sfida jonë me të sotmen, që ka nevojë të rishqyrtojë të shkuarën, për ne dhe të ardhmen e fëmijëve tanë", - tha Sula para të pranishmëve. Ajo shtoi se krijimi dhe mbajtja gjallë e miteve të atyre që ishin në anën e ligjit dhe atyre që ishin në anën tjetër vazhdon prej thuajse 30 vjetësh, siç vazhdon stigma dhe ndjesia e fajit në shoqëri, e atyre që për 45 vjet ishin pjesë asaj ane të murit, pasardhës të armiqve, familjarë të tyre dhe vijuan të jenë "armiq" edhe për 30 vitet e transicionit tonë të stërzgjatur. "Shumë prej tyre, pa pasur mundësi të ridimensionohen, të paragjykuar që nga prejardhja, prapë matanë, pavarësisht se muri u shemb, por shoqëria nuk pati mundësi, vullnet, politika të shembte muret e saj të larta e të qëndrueshme, që me sa duket, me kalimin e viteve krijojnë një kuadër të përçudnuar të Shqipërisë së sotme në kapërcyell", theksoi Sula.

## TEMAT

"Armiku i popullit" u trajtua nga pikëpamja filozofike, historike, politike, shoqërore, kulturore... Diskutimi teorik mbi konceptet "disidencë", "disident", "kundërshtar politik" u pasua nga lufta e klasave, tipologjia e njeriut të ri gjatë socializmit, sjellja e regjimit ndaj klerit katolik shqiptar, klerit ortodoks në Shqipëri, "armiku i djeshëm", "kundërshtari i sotëm"; ngjashmëritë dhe dallimet në vizatimin e "armikut të popullit", imperializmi amerikan-armik i përhershëm i regjimit komunist në Shqipëri, projektimi i "armikut të popullit" dhe ideologjia e tjetërsimit të individit, metamorfoza e "armikut të klasës" në radhët e Ushtrisë Popullore, nga "oficeri i deklasuar", tek "oficeri puçist dhe oficeri poliagjent", koncepti i "armikut" në aktet politike në fundin e vitit 1990 dhe fillimet e vitit 1991; imazhe, armiq dhe vese në shoqërinë komuniste; tipologjia e "armikut të popullit" në art, në romanet e novelat me agjenturë të realizmit socialist; kleri si "armik i popullit" në letërsinë shqipe, përjashtimi nga historia e letërsisë, si dënim për shkrimtarët "armiq", fati i revistave kulturore "reaksionare" pas vendosjes së diktaturës; disidenca shqiptare midis mitit dhe realitetit; "çamët e pabesë" si kundërshtarë politikë të regjimit komunist e punime të tjera, me emra e profile konkrete "armiqsh të popullit". Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, në bashkëpunim me Institutin e Historisë pranë Akademisë së Studimeve Albanologjike, Institutin për Studimin e Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit dhe Institutin për Integrimin e ish-të Përndjekurve Politikë organizon konferencën ndërkombëtare shkencore me temë "Fytyra e 'Armikut të Popullit' gjatë diktaturës së proletariatit në Shqipëri, 1944-1990". Konferenca u zhvillua përgjatë gjithë ditës në mjediset e Muzeut Historik Kombëtar. Gjatë ceremonisë së hapjes u mbajtën fjalët e organizatorëve dhe përfaqësuesve të trupit diplomatik, në praninë e studiuesve, kërkuesve shkencorë, përfaqësuesve të shoqatave të të drejtave të njeriut, të universiteteve të vendit dhe studentëve, organizatave ndërkombëtare dhe institucioneve publike e joqeveritare. Në fjalën e saj, kryetarja e Autoritetit, Gentiana Sula, e vuri theksin te rëndësia e trajtimit të një subjekti të tillë në Shqipërinë postkomuniste, e cila ka nevojë ta rishikojë narrativën e regjimit dhe t'i rivlerësojë viktimat, ende të përndjekura nga stigma.

Bashkorganizatorë të konferencës mbajtën fjalën e tyre, Marenglen Verli, rektor i Akademisë së Studimeve Albanologjike; Agron Tufa, drejtor i Institutit për Studimin e Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit dhe Bilal Kola, drejtor i Institutit për Integrimin e ish-të Përndjekurve Politikë, duke paraqitur këndvështrimet përkatëse ndaj temës, trajtimit të saj dhe nevojës së shoqërisë shqiptare për njohje e studim të thelluar të së shkuarës.

Konferenca u përshëndet nga Elva Margariti, ministre e Kulturës dhe zv.ministri i Mbrojtjes, Petro Koçi.

Përfaqësitë diplomatike në Tiranë, të pranishme në ceremoni, dhanë mbështetjen e tyre për këtë nismë, duke paraqitur propozimet përkatëse sa i takon trajtimit të drejtësisë tranzicionale në vend. Bernd Borchardt, Prezenca e OSBE-së, Johann Sattler, ambasador i Republikës së Austrisë; Alberto Cutillo, ambasador i Republikës Italiane; Karol Bachura, ambasador i Republikës Polake dhe Monika Bylaite, Delegacioni Europian në Shqipëri paraqitën qëndrimet e tyre ndaj rëndësisë së një konference të tillë në Shqipërinë postkomuniste. Borchardt e vuri theksin te mospërsëritja e së shkuarës, z. Sattler ngriti zërin për ruajtjen e vendeve përkujtimore si burgu i Spaçit. Alberto Cutillo solli përvojën e dhimbshme të kërkimit të të atit të Aldo Terruzit, Giuseppe Terruzi; z. Karol Bachura bëri thirrje për ngritjen e një memoriali në përkujtim të rezistencës dhe viktimave të komunizmit. Monika Bylaite, përmes fjalëve të atë Zef Pllumit ftoi për reflektim përballë krimeve të së shkuarës. Përfaqësuesit diplomatikë e mbështetën nismën e trajtimit të të ashtuquajturve "armiq", po ashtu vijimësinë e konferencës me profile të tjera. Prof. asoc. dr. Sonila Boçi prezantoi punimin e saj "Disidentë pa disidencë: përsiatje mbi veçoritë e totalitarizmit në Shqipëri", i pari i një dite të pasur, ku studiues shqiptarë e të huaj, kërkues shkencorë, historianë, aktivistë të të drejtave të njeriut dhe gazetarë diskutuan tematikën e zgjeruar të "armikut të popullit" në Shqipëri. Në mbyllje, moderatorët, bashkë me studiuesit dhe të pranishmit e interesuar mblidhen për konkluzionet e konferencës mbi tematikën e diskutuar. Puna për konferencën ka nisur prej muajsh dhe thirrjes për të marrë pjesë i janë përgjigjur me dhjetëra studiues shqiptarë e të huaj. Komisioni i vlerësimit përzgjodhi një pjesë të punimeve, duke i organizuar në panele të kërkimit shkencor dhe të kujtesës. Gjatë kësaj kohe, studiuesit kanë pasur mundësi të shfrytëzojnë inventarët, dosjet, statistikat dhe materialet e ndryshme arkivore të vëna në dispozicion nga AIDSSH apo të tjerë arkiva e, nëpërmjet kërkimit e objektivitetit shkencor, të mundësojnë një panoramë të zgjeruar të profileve të armiqve gjatë diktaturës, në aspektin historik, juridik, politik, filozofik, social e kulturor.

Opinioni i Ditës

# Shqipes i mungojnë dy flatra...

Nga Pano Hallko

*(vijon nga faqja 1)*

... ditë zie kombëtare e flamuri kombëtar në gjysmështizë. Shkaku ishte tragjedia me protagonistë dy ushtarakë shqiptarë, që ndodhi në Letoninë e largët.

E solli çasti dhe ora e keqe që të nesërmen e 5 majit të këtij viti, të merrnim dy plagë të rënda. Të na ikin dy njerëz të vlefshëm, jo të zakonshëm, jo si gjithë ne të tjerët, por dy ushtarakë të Forcave tona të Armatosura. Ai çast-ora e keqe bëri që një vajzë e re ushtarake, nëntetare Zarife Muharrem Hasnaj, shoqet e së cilës ende nuk e kanë nisur jetën, e një oficer, major Klodian Basri Tanushi, baba i tre fëmijëve, të mos kthehen më në shtëpitë e tyre, siç ikën në dhjetorin e kaluar. Ata kaluan njëri nga Pallati i Kongreseve e tjetri nga Muzeu Historik "një vizitë", e pastaj mbi shtratin e topit, shkuan lart, në kodrinën më të bukur që ka atdheu ynë, te Varrezat e Dëshmorëve...

Marksi (që shqipot e gënjeshtërt, injorantë e nopranë, për të zezën e tyre, këto 29 vite e shajnë dhe e anatemojnë), thoshte: "Rënia e dëshmorëve, i përngjet perëndimit të diellit...".

Por, dielli gjithmonë rilind. Edhe dëshmorët tanë rilindin në çdo 5 Maj të çdo viti, kur kombi u përulet me respekt, e politikanët (të ndarë), shkojnë dhe i nderojnë, në mënyrën e tyre, kuptohet. Dëshmorët do të nderohen mirëfilli, kur të (ri)zënë vendin që u takon, eshtrat e shenjta të Heroit të Popullit tonë, Qemal Stafa.

Në shtetet serioze, gjithmonë numrit të popullsisë që jepet nga statistikat, i shtohet edhe numri i dëshmorëve. E kjo nuk është një shtesë e thjeshtë. Shpeshherë, ata (të rënët) kanë forcë më të madhe sesa të gjithë ne të gjallët në edukimin e brezave. Kjo ndodh në botë. Ndodhte edhe te ne. Ndërsa sot, kopeja e "historianëve" të Tufës ka nisur t'i ndajë në grupe edhe ata. Terroristë i quanin fashistët e nazistët në propagandën e tyre në luftë, e kriminelë i cilëson kopeja e Tufës, dëshmorët dhe heronjtë e kombit tonë...

## "LUFTA ME MINAT", LUFTË ME MEMON...

Në Fakultetin e Xhenios, në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve "Enver Hoxha" ka qenë një pedagog që jepte lëndën "Lufta me Minat". Ai quhet Memo Skëndaj. Ajo lëndë u kthye në tmerrin jo vetëm të xhenierëve, por edhe të fakulteteve të tjera. Profesor Memo Skëndaj vendoste vetëm dy nota në vlerësimin e studentëve: 4, ose 10. Kaq i tmerrshëm u bë ai pedagog, saqë studentët e të gjithë shkollës ia ndërruan emrin asaj lënde. E mbitituluan, "Lufta me Memon". Vlerësimi ishte shumë kuptimplotë. Nëse vlerësoheshe me notën 4, ishe vrarë në minim, apo në çminim. Nëse arrije notën 10, kishe shpëtuar vetëm, por edhe shokët. Kaq e vërtetë



është kjo, saqë mjafton vetëm një shembull. Futbollisti i mirënjohur i Kombëtares sonë Perlat Musta u vlerësua me notën 4. Ai nuk studionte për xhenier. Ishte një klasë sportive, në Fakultetin Gjitharmësh. Por edhe ata e jepnin provim atë lëndë. As ndërhyrja personale e komandantit të shkollës, Rustem Peçit "nuk piu ujë". Kështu, Perlat Musta e humbi vitin dhe shkollën vetëm për këtë lëndë. Nuk e mbaroi dot Shkollën e Bashkuar. Por nuk i ndërhyri pedagogut as dekani i fakultetit, i mirënjohuri Habil Zerani, e as shefi i katedrës së Xhenios, dinjitozi Koli Dano.

E pedagogut dinjitoz nuk iu prek as maja e flokut. Ai vazhdoi të jepte mësim deri sa e flakën, "në kuadër të reformës". Në kulmin e pjekurisë dhe të aftësive të tij.

Me dashamirësinë e të gjithë Komandës, me një manovrim të lehtë, u titullua oficer në shkollën e Zall-Herrit... Solla këtë shembull, meqë njihet prej të gjithë shqiptarëve. Por janë me dhjetëra ata, që janë djegur në lëndën "Luftë me Memon". Mund të pyesë lexuesi i këtyre radhëve: - E ç'i duhej lufta me mina, futbollistit të Kombëtares Perlat Musta? Shumë e thjeshtë përgjigja: Ai do të titullohej oficer. E oficeri Perlat Musta duhej ta njihte shkëlqyeshëm. Sepse në kohë lufte mund të ndodhte që vritej xhenieri i njësisë e minimin apo çminimin duhej ta bënte Perlati. Sado të pabesueshme të na duken sot këto.

Arsimimi, formimi dhe ngjizja e oficerit në shkollën tonë kombëtare është një problem tjetër, të cilin shteti ynë me kalimin e kohës do ta gjejë përpara e do të duhet të reflektohet në praktikë. Por, kjo përbën objekt analize për aktorët dhe faktorët në këtë vend...

## XHENIER...

Para shumë vitesh, e paharruara Ledi Diana në një fushatë që ndërmori për të grumbulluar ndihma për ata që ishin gjymtuar nga minat anembanë globit, i cilësoi zonat e minuara si një... Çmenduri të njerëzimit!

Dianën (që ne shqiptarët "anglishtfolës të thekur", e quajmë edhe Dajana), e vrau pallati i saj, për arsyet që i di vetëm ai... Atëherë mësova se ata që minojnë zona të caktuara, por që edhe i çminojnë ato janë po të njëjtët, xhenierët.

Në këtë kuptim, xhenierët (e jo vetëm ata shqiptarë), kanë një profesion sa të "bekuar" në mbrojtje, aq edhe të "mallkuar" në sulm. S'ke ç'i bën, janë ligje të luftës dhe të mbrojtjes, e nuk mund të bëhet dot ndryshe.

Ashtu siç u sakatuan për të hequr minat, që ushtarakët e shtetit shoven serb kishin "mbjellë" në Kukës, Has e Tropojë në mungesën totale të shtetit shqiptar, jo më larg se njëzet vite më parë.

Shkruesi i këtyre radhëve, "leksionin" e parë për xhenierin e mori në Bazën e Butmirit në Bosnjë, ku kishim një togë EOD. Ishte komandant i atij misioni, një xhenier i talentuar, major Luan Shaba. Shumë i aftë, ai kishte fituar respektin e gjeneralmajorit italian-Kastaniotit, komandant i asaj baze. Foli me superlativa për xhenierët tanë. "Më kanë shpëtuar jetën disa herë", - më tha gjenerali...

Një jetë të tërë, Luan Shaba kishte ngrënë dynjanë. Familjen me katër fëmijë, në një fshat të Kavajës. E vetë me çminime e demontime. Në Tepelenë (Dhëmblan), në Burrel, në Berat, në Elbasan, në Korçë, në Gjirokastër (për dy vjet), por edhe në Përmet. Ishte po ky xhenier që dha ndihmën e pakursyer edhe në rastin e Gërdecit. Pikërisht se ishte tepër i aftë, jo vetëm që nuk i dhanë gradën e nënkolonelit, por e përzunë "me reformë" në shtator të vitit 2013. Në moshën 44-vjeçare! Mirëpo u gjetën ca "budallenj" të huaj, norvegjezë në mos gaboj, që e kanë punësuar xhenierin tonë...

Ligji i pashkruar i Xhenios thotë që në dallim nga të gjitha specialitetet, xhenieri vetëm një herë "ka të drejtën" të gabojë. Rast i dytë nuk "i jepet".

Major Klodian Basri Tanushi nga Muhurri i Peshkopisë ishte pajisur nga natyra, përveçse me zgjuarsinë karakteristike, edhe me karakter të fortë e me trup atleti. Shoqëruar të gjitha këto me krenarinë e ligjshme që ndiente, si djalë oficeri. Ai pasi mbaroi arsimin e mesëm në vendlindje, u shkollua në vitet 2000-2003 në Akademinë Ushtarake "Skënderbej", në specialitetin tankist. Me kurse të njëpasnjëshme e me trajnime të vazhdueshme të certifikuara edhe nga aleatët amerikanë, ai përvetësoi specialitetin e xhenierit...

## VDIQËN, APO RANË?!

Në gjuhën shqipe që patëm (edhe për këtë jemi katandisur të themi: "patëm"), e në Fjalorin e Shqipes nga Akademia e Shkencave që patëm, faqe 1024, thuhet, citoj: 3. "-RËNË"(si em.kryes.sh.~I(të)fig. Dëshmorët. Gjaku (amaneti) i të rënëve. Kujtojmë me nderim të rënët".

Qatipët mjeranë që kanë shkruar ceremonialin e përcjelljes së Dëshmorëve të Atdheut, në terrin e tyre gjuhësor e në varfërinë e skajshme mendore të tyre, kanë vendosur për të zezën e të rënëve dhe tonën ("të gjallëve"), fjalët "vdiq në krye të detyrës!". Sepse tremben nga fakti që shteti që patëm, i respektonte dëshmorët me emrin-të rënët. Tremben se mos e konsiderojnë si "terminologji të diktaturës". Kjo farë "ushtaraku", më kot e harxhon gjithë atë basmë për pantallona. Ndaj, është vetëm faji i tyre e i asnjë ministri që ka kaluar nga ai dikaster. Ashtu si edhe për uniformën, ushqimin, pagat etj., pasi të gjitha procedurat, për çdo gjë, shkruhen nga duart e ushtarakëve e miratohen nga nivelet e larta.

Dhe kanë përkthyer me translеter (pasi nëse nuk njeh thellë gjuhën tënde, nuk mund të njohësh mirë gjuhën e huaj), ato fjalët "moderne" të të huajve. Ndaj ata kanë "të drejtë" në fukarallëkun mendor të tyre.

Sepse ata nuk mund të dinë që gjërat e shenjta për një komb nuk mund të kenë të njëjtën fuqi dhe vlerë për një komb tjetër, në formulimin dhe shprehjen e tyre. E njëjta gjë është në fuqi edhe për ligjet etj., etj...

Njeriu vdes kudo, sidomos në këto vite "të lumtura" të tranzicionit të stërzgjatur enkas që jetojmë. Ai vdes në shtëpi, në të gjitha ambientet e saj, nga salloni-kuzhina, dhoma, me raste, pse jo, edhe në nevojtore.

Njeriu mund të vdesë në rrugë, spital (të pasurit në privat, ku mjekohen nga mjekët e spitalit të shtetit e të varfrit në spitalin shtetëror), hotel, motel, në makinë, autobus, tren, aeroplan, në arë, pyll, apo në mal.

Mund të ndodhë të vdesë (llafi nuk sjell gjë!), edhe deputeti (me mandat në xhep), në çdo lloj ambienti. E për këtë të fundit (nëse është në rrogë), thuhet: - vdiq në detyrë. Sepse është në detyrë, pavarësisht se ku vdes (e me cilin, apo me cilën në prehër). Pra, këta vdesin në detyrë. E përcillen edhe këta, me ceremonial.

Kurse ushtaraku nuk "vdes" në krye të detyrës. Ushtaraku nuk është (më së paku nuk duhet të jetë) si gjithë ne të tjerët.

Ushtaraku brilant i këtij kombi, e Esenini i shqipes, i pavdekshmi poet Hysni Milloshi, në poemën "Atdheu" botuar në vitin 1987, shkruante:..."Perënditë Sazanin mbrojnë, e Otranto, e Rivierë/ Perënditë për ty Atdhe, janë veshur oficerë/Oficerët e armatës, shkrirë në shpatën e Lirisë/Ngrihen si martirë të gjallë, para kombit, historisë!" (Libri "Atdheu" bot. 2007, fq. 103).

Pra, ushtaraku bie në krye të detyrës, në stërvitje, luftë apo në mision. Dhe as "vdes" e as "vritet". Në Tiranë vdesin e përcillen 15-20 bashkënjerëz tanët në ditë, çdo ditë të vitit (dhe lindin 17!). Prandaj, nëse do themi në ceremonial për ushtarakun fjalën vdiq, le ta përcjellim në Tufinë ose në Sharrë, sipas parcelës...

Por le t'u referohemi disa shteteve, se si shprehen në gjuhët e tyre. Anglezët thonë: - "For the fallen" ("Për të rënët"). Madje, është edhe titulli i një poezie kushtuar ushtarëve të rënë në luftë, që e kanë kthyer në himn. Italianët shk-

Opinioni i Ditës

# Në kërkim të dëshpëruar të emisarit perëndimor

Nga Fatos Çoçoli

*(vijon nga faqja 1)*



... dhe më pak i thellë se ky i sotmi. Pavarësisht se atëherë opozita, e mbyllur në një çadër të madhe në bulevard kërcënonte të bojkotonte zgjedhjet e përgjithshme. Tani, edhe pse janë vetëm zgjedhjet vendore, hapësira për një rënie dakord duket gati zero. Opozita ka braktisur përfundimisht parlamentin. Ka përshkallëzuar dhunën dhe gjuha e saj është bërë e drunjtë, gati një fjalor ushtarak. Pozita qëndron e vetëkënaqur me vetëpërmbajtjen e policisë, që deri tani, për fat, nuk ka shkaktuar viktima në njerëz në përballjen me protestuesit e revoltuar. Pozita dhe qeveria nuk duken të gatshme të lëshojnë asnjë metër terren. Ndërkohë, apeli i kryetarit të opozitës ka rënë në vesh të shurdhër në kancelaritë perëndimore. Asnjë reagim nga partnerët ndërkombëtarë për dërgim misionesh. Dy vjet më parë, situata ishte krejt ndryshe. Kjo, për shkak se Ballkani dukej me të vërtetë një fuçi baruti, sikurse e ka nofkën historike. Maqedonia më e pasigurt se kurrë, me rezultatet e paqarta të zgjedhjeve të përgjithshme. Kosova në një krizë identiteti të palëve antagoniste në politikë dhe Shqipëria, me opozitën e mbyllur për mbi tre muaj në çadër. Në misione të shkurtra të njëpasnjëshme erdhi në rajon në gjysmën e parë të majit "Buldozeri", Zëvendës-Ndihmës Sekretari i Shtetit të SHBA-ve për Evropën dhe Euro-Azinë, Hoyt Brian Yee. Ia kishin ngjitur nofkën "Buldozeri", ngaqë tregohej mjeshtër për të sheshuar mosmarrëveshje politike. Në Tiranë Yee erdhi më 15 maj 2017. Dy vjet më vonë, ndoshta kryetari i opozitës sonë e kujton me nostalgji një personazh të tillë. Yee po që dinte se si të bindte politikanët e Ballkanit Jugperëndimor. Brenda 24 orësh zgjidhi situatën e komplikuar në Maqedoni, gjendjen në Kosovë me zgjedhjet e jashtëzakonshme dhe përgatiti terrenin për marrëveshjen e 18 majit në Shqipëri. Kurse tani në horizont nuk duket asnjë emisar apo bisedues nga Komisioni Evropian, Parlamenti Evropian e, aq më pak, nga SHBA-të. Asnjë propozim për ndonjë paketë bisedimi e rënie dakord jo e jo, por as edhe ndonjë zhurmë apo lajme për përpjekje, për organizime misionesh nga aleatët tanë të mëdhenj e të patjetërsueshëm perëndimorë. Po pse? Sepse situata në Maqedoni është qetësuar mjaft, me emrin e ri që ky vend ka marrë si Maqedoni e Veriut dhe marrëveshjen me Greqinë. Sepse situata në Kosovë paraqitet e qëndrueshme, pavarësisht mosmarrëveshjeve me Serbinë. Në këtë këndvështrim, si për Brukselin, edhe për Uashingtonin, "pranvera" e protestave në Ballkanin Jugperëndimor ka përfunduar si koncept. Protestat e opozitës sonë janë, si të thuash, jetime në gjeopolitikën e rajonit. As veprimi i saj ekstrem i braktisjes masive të mandateve të përfaqësimit në parlament nuk bëri të lëvizte asnjë muskul në damarët e ndjeshmërisë së aleatëve tanë perëndimorë. Shqipëria atyre u duhet me reformë drejtësie të plotësuar dhe asnjë veprim që nuk çon ujë drejt realizimit të kësaj reforme nuk ka vëmendjen e tyre. Atëherë, kush do t'i vendosë në një tavolinë bisedimi qeverinë tonë të patronditur dhe të mikluar nga dënimi i njëzëshëm prej aleatëve i dhunës në protestat e opozitës dhe këtë opozitë tonën, të lodhur dhe çmotivuar nga qëndrimi tre muaj nëpër rrugë? Që bën revolucionaren dhe guerrilasen, ngaqë nuk i ka ngelur asnjë taktikë tjetër për të gënjyer veten dhe militantët? Artikuj kritikues apo edhe denoncues nëpër gazeta e revista perëndimore mund shumë-shumë të karikojnë dhe motivojnë militantët e lodhur, por jo të ndryshojnë gjë në skakierën bosh të bisedimeve pozitë-opozitë në Shqipëri. Ndoshta e vetmja mundësi do të ishte për qeverinë të shikonte precedentin e shtyrjeve të zgjedhjeve vendore të vitit 2007. Nga qorrsokaku ku është futur, opozita ka nevojë të dëshpërueshme për kohë dhe shtyrja e zgjedhjeve vendore për muajin shtator ose tetor mund të krijonte hapësirën kohore të mjaftueshme për të gjetur ndonjë shteg rënieje dakord. Qeveria duhet të kuptojë se vendit më pak se çdo gjë tjetër i nevojiten protesta të stërzgjatura dhe të dhunshme deri në fund të qershorit, kur vjen data e zgjedhjeve. Deri tani kosto e protestave tremujore shkurt-maj 2019 ka shkuar mbi 90 milionë euro.

---

ruajnë në lapidarët e tyre që ngrenë për të rënët (pra fjala lapidar-nuk na qenka vetëm në shqip, e as vetëm "labe")... "Caduti Per la Patria". E francezët, përdorin shprehjen: "Tombe pour la France" pra (Rënë për Francën). Kurse gjermanët, thonë e shkruajnë: "Major x, kam ums Einsatz".

Edhe shteti turk i quan e i shkruan dhe nderon me një fjalë të vetme: "Shehit"!

Po kështu, grekët i quajnë- "I pesondes" - pra, të rënët. Kështu i quajnë ata edhe ushtarët pushtues të 1913-ës e të 1940-tës, vrarë në Shqipëri, për... "çlirimin" e kësaj të fundit. Ata thonë për ushtarakun, épese(RA)-e jo apothane-pra vdiq. Nuk besoj se ka më nevojë për shembuj të tjerë, pa lere më për "debat", siç me shumë qejf e kemi na shqipot...

## NË PËRJETËSI!

Ora e keqe e solli që majorin, "ta thërriste në raport" nënteta-re Hasanaj. Ajo edhe pse vartëse e tij, një herë, "i dha komandën:- Major paraqitu"! Dhe ai u paraqit, krah saj, në apelin e përjetshëm, te Varrezat e Dëshmorëve...

Major Tanushi "hyri" natyrshëm në sheshin "Skënderbej", si një vizitor i interesuar i Muzeut Kombëtar. Sikur kish lënë pak më vonë një kafe me shokët e vet, e sa të vinin ata, tha ndër vete: -"Pa të hyj të shikoj njëherë, çfarë pavijoni të ri ka hapur punëshumi Dorian Koçi". Më të ngjitur të shkallëve, ndjeu një marrje mendsh, por shokët në të dyja anët nuk e lanë, e këmbët nuk iu përthyen. Sapo doli në krye të shkallëve, pa portretin e tij në krye të sallës së madhe.

## KOHËT DHE EPOKAT, FYTYRË MË FYTYRË....

E në krah të djathtë të fotografisë së tij ishte ulur e gjithë familja dhe fisi Tanushi. Ishte atje, babai Basriu e nëna e tij, Lumja. Por atje, më të djathtë, pa ulur bashkëshorten e tij Semin, me Darlën e tij të vogël në dorë, ulur mes dy djemve të tij, Serxhio dhe Klesio. -"Po mbështetem këtu te Flamuri - tha. T'ju kem kundruall të gjithëve. Erdhën dhe e takuan shumë, po shumë miq, kolegë e shumë bashkëqytetarë të tij të Tiranës. Si i takoi të gjithë me një prekje dore, e shkëmbeu me ta lamtumirën, u nis lart, atje ku e thirri Apeli i Përjetshëm që thërret të Rënët, tek "Nëna Shqipëri"...

Ministri i Mbrojtjes, zonja Olta Xhaçka, në ceremoninë e përcjelljes së nëntetar Zarife Hasanaj, ndër të tjera, tha: "Dhimbja juaj është edhe e jona. Jeni pjesë e familjes së madhe ushtarake. Do keni mbështetjen tonë për çdo nevojë. Ndarja nga jeta e Zarifes është një humbje e madhe për të gjithë ne".

Përqafimi i zonjës Xhaçka me Serxhion 13-vjeçar në aeroportin e Rinasit, ku ai priste të atin, flet sa për libra të tërë. Mekanizmat shtetërorë do të veprojnë e do mundësohet mirërritja dhe mirarsimimi i tre fëmijëve të major Klodian Basri Tanushit. Është detyrë e shtetit dhe e të gjithë shoqërisë. E do të realizohet...

Gjesti i dy ushtarakëve dëshmorë në Letoninë e largët zotëron hapësirat...

Flatrat ridalin te shqiponja, dielli që perëndon, rilind. E ata do të rilindin, çdo 5 Maj, të çdo viti. Sa të ketë komb dhe shtet shqiptar. Ne, të vdekshmit e zakonshëm nuk mundemi të rilindim dot.

Ndaj gjesti i tyre na krenon të gjithëve...

---

## HOROSKOPI

### DASHI
Edhe një natë e qetë mund të shndërrohet në një aventurë të çmendur. Jeta juaj shoqërore është padyshim duke marrë një kthesë të fortë tani, por kjo është për mirë. Parashikohet të jetë e mbushur me argëtim.

### DEMI
Dikush rreth jush po punon për diçka që mund të bëhet e suksesshme. Nëse mund ta përfshini veten me këtë projekt, mund të përfitoni financiarisht dhe nga ana intelektuale. Gjeni se si mund të angazhoheni sot.

### BINJAKET
Nuk ka nevojë të frikësoheni për të pasur progres tani. Gjërat për të cilat shqetësoheni janë drejt zgjidhjes. Nëse keni qenë të shqetësuar për një person, qetësohuni sepse ai është në gjendje t'i zgjidhë vetë situatat e ndërlikuara.

### GAFORJA
Nëse keni nevojë për të arritur një qëllim që i keni vënë vetes, gjasat janë që zgjidhja të vijë në momentin e duhur. Sa i përket çështjeve të zemrës, mund të merrni lajme pozitive.

### LUANI
Nëse keni pritur për një kohë të gjatë që dikush të trokasë në derën tuaj me një "biletë" të artë për të ardhmen tuaj, jeni duke humbur kohë të çmuar. Premtimet që njerëzit kanë bërë për ju janë të vërteta, por ato mund të kërkojnë shumë më tepër kohë për t'u përmbushur.

### VIRGJERESHA
Për të marrë atë që dëshironi me të vërtetë mund t'ju duhet të mposhti krenarinë. Jeni të përgatitur të pranoni se keni gabuar, ose të paktën të kërkoni ndihmën që nuk e keni menduar ndonjëherë se do t'ju nevojitet.

### PESHORJA
Nuk ka asgjë si një fillim i ri në një marrëdhënie të vjetër! Nëse jeni në një marrëdhënie të qëndrueshme, flisni me partnerin dhe mendoni për disa mënyra për të shtuar emocionin.

### AKREPI
Dikush të cilin e keni menduar se e njihni si brenda dhe jashtë mund t'ju shkaktojë zhgënjim. Ky mund të jetë fillimi i një faze të re për të dy. Shprehuni qartë rreth gjërave që mendoni se nuk po funksionojnë.

### SHIGJETARI
Të përballeni me një të vërtetë të pakëndshme nuk është e lehtë. Një person në jetën tuaj po kalon një transicion të madh dhe kjo nuk mund të jetë diçka për të cilën jeni të lumtur.

### BRICJAPI
Edhe nëse ndiheni sikur jeni në një pikë kthese të madhe në jetën tuaj, qëndroni me këmbë në tokë. Një person i dashur ka nevojë për një dëgjues të mirë dhe ndoshta një shpatull për t'u mbështetur.

### UJORI
Merrini me rezerva gjërat që dëgjoni nga një person tek i cili keni shumë besim. Do të ishte më mirë që t'i merrni vendimet bazuar në fakte. Në dashuri mund të keni nevojë për ndryshime të mëdha.

### PESHQIT
Kjo është një ditë për të përjetuar romancë dhe për t'u qëndruar larg intrigave dhe mashtrimeve. Në aspektin profesional, dikush mund të përpiqet të përhapë thashetheme, të cilat duhen trajtuar me qetësi nga ju.



### Ndaj Kastriotit do të luhet me dyer të mbyllura

## E habitshme, Tirana lë jashtë tifozët!

Duket e habitshme, por është e vërtetë! Tirana-Kastrioti do të luhet pa praninë e tifozëve dhe ky vendim është marrë nga drejtuesit e klubit bardheblu, që kanë vendosur të mos e konvertojnë me gjobë pjesën e mbetur të dënimit, duke zgjedhur të luajnë me stadium të boshatisur sfidën vendimtare kundër Kastriotit. Tirana do të presë sot krutanët në "Selman Stërmasi" në kuadër të javës së 34-ët të Kategorisë Superiore, me bardheblutë që luajnë takimin e rëndësishëm që vlen mbijetesën, kjo sepse Kastrioti i vendit të parafundit gjendet në kuotën e 38 pikëve, 2 më pak se Tirana. Ndaj, në kushte të tilla duket mjaft i habitshëm ky vendim i presidentit Halili, që ka vendosur të mbajë mbyllur dyert e stadiumit në këtë 90-minutësh tejet të rëndësishëm. Ende nuk dihet një motivacion konkret për këtë vendim, por dyshohet se te klubi i Tiranës mendojnë se sjellja gjatë ndeshjeve të fundit më shumë e ka dëmtuar psikologjikisht ekipin sesa e ka ndihmuar. Ndaj, ndonëse kjo hipotezë është në shkallën më të lartë habitore, duket se drejtuesit mendojnë se qëndrimi konfliktual i tifozërisë e ka dëmtuar ekipin e drejtuar nga Mema.

### Lojtarët të ndarë në dy klane, Dibala dhe Kanselo kundër teknikut, Khedira e Manxukiç pro

# E papritur, Juventusi i bën dalje Alegrit

## *Ëndrra quhet "Guardiola", por Pep s'lëviz nga Siti*

Juventusi më në fund ka plotësuar dëshirën që tifozët kishin prej kohësh, duke larguar nga stoli trajnerin Masimiliano Alegri. Lajmi u bë i ditur nga vetë sajti zyrtar i klubit bardhezi, që në një komunikatë për shtyp njoftohet se Alegri nuk do të jetë më në krye të stolit për sezonin e ardhshëm. Ai do të drejtojë bardhezinjtë në dy ndeshjet e mbetura dhe më pas do të largohet për të kërkuar një aventurë të re. Objektivi kryesor i Alegrit ishte fitimi i Ligës së Kampionëve dhe këtë sezon kishte mundësinë më të mirë, por u eliminua në çerekfinale nga holandezët e Ajaksit.



**DËSHIRA QUHET GUARDIOLA**

Ende nuk është bërë i ditur emri që do të vihet në krye të stolit bardhezi, por mediat italiane raportojnë se dëshira e drejtuesve është ajo e Guardiolës, ndonëse ky i fundit është shprehur negativisht. Spanjolli do të ishte trajneri perfekt për të synuar fitimin e titullit kampion, por Pep i largon me shumë vendosmëri zërat që e shohin drejt një transferimi në Torino. "Sa herë duhet t'ua them? Nuk shkoj te Juventusi, nuk shkoj në Itali. Jam i lumtur këtu dhe nuk iki askund. Vitin tjetër do të jem sërish trajner i Mançester Sitit. Jam i kënaqur që punoj në këtë klub dhe me këta djem. Sot ndihem kështu, ndonëse futbolli ndryshon shpejt. Sezoni im i ardhshëm do të jetë më i vështirë, por do të jem trajner i Mançester Sitit", ka theksuar trajneri spanjoll.

**DISA FESTOJNË, DISA JO**

Padyshim që ndërprerja e marrëdhënies mes Masimiliano Alegrit dhe Juventusit ka qenë lajmi i ditës dje. Trajneri livornez dhe klubi bardhezi i kanë dhënë fund një martese 5-vjeçare, e kurorëzuar me 11 tituj të fituar, mes të cilëve 5 tituj kampionë radhazi, që vijuan ecurinë e mëparshme të ciklit "Konte". Alegri nuk do të qëndrojë më në krye të Juventusit pas përfundimit të këtij sezoni, ndërsa do të dalë sot në një konferencë për shtyp bashkë me presidentin Anjeli, ku do të sqarojnë arsyet e këtij divorci, që ka befasuar jo pak ambientin bardhezi, pasi më herët ishte folur për një rinovim të kontratës së trajnerit livornez. Me largimin e Alegrit ndryshojnë krejtësisht strategjitë e merkatos së Juventusit. Sipas asaj që raporton "Calciomercato", Nedved dhe Paratiçi do të nisin të ndërtojnë skuadrën e re. Lojtarë që priten të konfirmohen janë Kanselo dhe Dibala, të cilët vuajtën jo pak me Alegrin, ndërsa me valixhe në dorë mund ta konsiderojnë veten Pjaniç, Manxukiç, Khedira, Aleks Sandro, Duglas Kosta dhe De Shiljo.

FRANCEZI

## Riberi: Unë dhe Roben ndryshuam Bajernin

Frank Riberi ka dhënë një intervistë për faqen zyrtare të Bundesliës, në vigjilje të ndeshjes së tij të fundit me fanellën e Bajernit të Mynihut, ku francezi ka luajtur për 12 sezone me radhë. Riberi, që së bashku me Arjen Roben u shndërruan në një dyshe emblematike në Bavari, rrëfen atë që ata të dy kanë bërë për Bajernin. "Te Bajerni më parë kishte një tjetër mënyrë loje. Kur Arjeni, unë dhe të tjerët erdhëm, sollëm më shumë shpejtësi dhe dinamizëm. Një tjetër tip futbolli. Jemi krenarë për atë që arritëm. Nuk mund ta harroj kurrë kur mbërrita në vitin 2007. Bajerni nuk ishte kualifikuar në Champions League në atë sezon. Tani, pas 12 vitesh shoh me krenari sesa shumë kemi fituar".



SEKTORI MIK

## Leksion nga Franca, barazi në çmimin e biletave

Nuk do të ketë më çmime sipas qejfit të drejtuesve të klubeve. Nuk do mbahen më tifozëri me hatër dhe të tjera të mbahen larg. Liga Profesioniste e Futbollit në Francë ka vendosur që të unifikojë tërësisht biletat e sektorëve mik në të gjitha stadiumet dhe në të gjitha ndeshjet e kampionatit. Natyrisht që jo çdo kategori do të paguajë njësoj. Kështu, nga sezoni 2019-2020, çmimi i biletave në sektorin mik do të jetë 10 euro për të gjitha ndeshjet e Ligës 1, ndërsa 1.5 euro për të gjitha ndeshjet e Ligës 2. Kjo vjen me qëllimin për të mbushur stadiumet dhe për të lehtësuar transfertat masive të tifozëve, që shpenzojnë jo pak para për të ndjekur skuadrën e tyre të zemrës.





### Vijon festa e kuqe

## Tifozët e Partizanit marshojnë në autokolonë drejt Durrësit

Partizani u shpall matematikisht kampion për herë të parë pas 26 vitesh pritjeje, ndërsa tifozët e kuq vijojnë ende të jenë në delir për këtë sukses që e kishin pritur për më shumë se një çerekshekulli. Ultrasit e kuq po vijojnë organizimet që do të kulmojnë me festën e madhe të ngritjes së trofeut, teksa kanë bërë me dije edhe detajet për transfetën e radhës, ku të besuarit e Gegës do të jenë të impenjuar në Durrës ndaj Teutës vendëse. "Ultras Guerrils" kërkon të rikthejë edhe njëherë transfertat e dikurshme në autokolonë, me tifozët e kuq që pushtonin kryeqytetin me alegrinë e tyre, ndonëse ekipi lëngonte në ligat e ulëta të futbollit. Ndaj, edhe nesër pritet një rikthim i festës "old style", çka padyshim do ta bëjë edhe më të bukur këtë fundkampionati për të gjithë tifozët e Partizanit.


www.gsh.al
GAZETA SHQIPTARE
Gazeta e gjithë shqiptarëve!
MARKETING: 0688087323
GSH
www.gsh.al
Kontakt: +355 68 40 63 842
Facebook: Gazeta Shqiptare
Intagram: gazetashqiptare.al
Twitter: Gazeta Shqiptare
E-mail: gazetashqiptare.al@gmail.com
YouTube
Youtube: Gazeta Shqiptare
• Na merrni!
• Na shkruani!
• Na lexoni!
GAZETA SHQIPTARE
PENSIONET E PLEQERISE, ISSH: SI T'I LLOGARISNI
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al